

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7596 E shtunë 21 Korrik 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

Hezitimi i ambasadorit amerikan, Greg Delawie për t'u deklaruar hapur kundër ndarjes nuk ishte qëndrim i ri amerikan, ishte një mosqëndrim ...
Vijon në faqen 20

Nga BERAT BUZHALA

Ndarja e Kosovës dhe një diplomaci në kaos



Opinion

Ditës

Nga VINCENT TRIEST

Në klasën politike në Shqipëri, e cila nuk shquhet për transparencë ndaj publikut, është shpesh e vështirë të kuptohet se pse disa njerëz marrin ...
Vijon në faqen 21

Si duhet ta lexojmë mbështetjen ndërkombëtare për ministrin Xhafaj?



Pasuria familjare, 58.7 milionë lekë

Kryegjyqtari i Lartë, KPK: Nuk pagoi taksat. Zaganjori: 40 vite punë, asnjë cent korrupsion

Kaloi procesin e vetingut, ONM do apelim për kreun e Kushtetueses, Bashkim Dedja

TIRANË- Kryetari i Gjykatës së Lartë, Xhezair Zaganjori është përballur dje me procesin e vetingut. Ai ka marrë pjesë në seancën dëgjimore të zhvilluar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit që drejtohet nga Olsi Komici, me anëtarë Roland Ilia dhe Pamela Qirko. KPK, referuar raportit të ILDKPI bëri me dije se Zaganjori ka bërë ...
Në faqen 9

DREJTORI I ALUIZNI-t: SI MERRET TAPIA PER OBJEKTET PA DOKUMENTACION

60 MIJE NDERTIME PARA '91, PROCEDURA E LEGALIZIMIT

Artan Lame shpjegon vendimin e ri të qeverisë: Aplikantët duhet të paraqiten nga shtatori në zyrat e ALUIZNI-t. Trualli falas deri në 200 metra katrorë



(Në foto) Kreu i ALUIZNI-t, Artan Lame

KRYETARI I PD

Lulzim Basha: Do t'u vëmë minat kullave nëse do prishet Teatri

Në faqen 3

KOMPENSIMI

ATP, lista me emrat e pronarëve që do të ndajnë 224 milionë lekë

Në faqen 10

PREMTIMI

Rama: 11 milionë euro për agroturizëm, në vjeshtë nisin aplikimet e fermerëve

Në faqen 2

HISTORIA

Ekstradohet nga Kosova i riu që donte të vriste Lul Berishën në 2005

Në faqen 8

NDRYSHON LIGJI



Dëshmëpërblimi i të përndjekurve, si mund të merret me 1 këst të vetëm

Në faqen 7



Modelja shqiptare vjen në një rrëfim ndryshe. Vajza e Majlinda Bregut i çmend të gjithë

Kristina Baki: Më ofruan 5 mijë USD për reklamë

Ledri Vula me Dua Lipën sërisht bashkë? Zbulohet darka familjare...

Nga PAMELA ALIAJ

Ajo është një nga vajzat më të bukura të Shqipërisë, titull i cili u vendos në vitin 2013 ku u kurorëzua si 'Miss Universe Albania'. Vajzë e thjeshtë dhe e dashur që gjithmonë është përpjekur të besojë e të japë besim por



nuk ka marrë pas atë që ka dhënë. Kristina Baki përfaqësuesja e Shqipërisë në 'Miss World 2015' në ishujt Hainan të Kinës tregon pasionet dhe heqjen dorë nga disa ëndrra të ndryshuara gjatë rrugës... Kaloi edhe një sezon i ngjeshur ...

Suplement

QEVERIA INVESTIMET

Kryeministri vërejtje krerëve të bashkive: Jeni larg procesit të transformimit në fshat

Rama: 11 milionë euro nga BE për agroturizëm, në vjeshtë aplikimet

"I gjithë diskutimi i kryetarëve është vetëm te rrugët"

Darina Tanushi

Kryeministri Edi Rama njoftoi dje, se në vjeshtën e këtij viti, do të hapet programi i mbështetjes financiare të Bashkimit Europian ku 11 milionë euro do të shkojnë për familjet dhe individët që duan të zhvillojnë agroturizmin. Gjatë takimit me kryetarë të bashkive për programin "100 fshatrat", Kryeministri u shpreh: "Në vjeshtën e këtij viti ne hapim programin e mbështetjes financiare të Bashkimit Europian, 11 milionë euro janë vetëm për të mbështetur familje apo individë që duan të investojnë në agroturizëm për familje që duan të zhvillojë agroturizëm në fshat". Por, ai bëri të ditur se ekziston një rrezik që këto para të mbeten të padisbursuara, për mungesë projektesh të besueshme dhe sipas kriterëve të BE. "Nuk janë kredi, por para në dorë, për të cilat patjetër duhet një aplikim i besueshëm, patjetër duhet një projekt i besueshëm, por ai që është rreziku ynë është që paratë të na ngelen të padisbursuara, për shkak se nuk kemi aplikime të besueshme, për shkak se nuk kemi projekte të besueshme. Për këtë arsye, bashkëpunimi juaj me qeverinë, me të gjithë aktorët që janë përfshirë në kornizë, është i domosdoshëm", - iu tha kryeministri, krerëve të bashkive. Kreu i qeverisë pati edhe vërejtje për kryetarët e bashkive, por i siguroi se qeveria do t'i mbështesë. Ai vuri në dukje se sa larg janë akoma bashkitë nga procesi i transformimit në fshat, "qoftë për faktin që në të gjithë procesin e aplikimeve për skemat e mbështetjes në bujqësi kontributi i bashkive ka qenë minimal, qoftë për faktin që qeveria ka qenë e detyruar ta rihapë thirrjen për projekte në agroturizëm si rezultat i mungesës së projekteve", tha Rama. "Kemi vënë në dispozicion një shumë të konsiderueshme për buxhetin e shtetit, që do të jetë mbështetja e drejtpërdrejtë për ata që investojnë në agroturizëm, që nga 5 milionë deri në 100 milionë, flas me të vjetra, si bashkëfinancim. Këtu nuk bëhet fjalë për kredi. Këtu bëhet fjalë për grant, për para që jepen për projektin pa asnjë interes nga ana e qeverisë. Numri i projekteve që kemi marrë ka qenë 10 herë më i vogël se numri i bashkive që kemi. Kjo është e pa-



Kryeministri Edi Rama gjatë takimit me kryetarë të bashkive për programin "100 fshatrat"

EMIGRANTËT

Kryeministri u kërkoi kryetarëve të bashkive që të sensibilizojnë emigrantët, për të investuar në fshatin e tyre, në shtëpinë e prindërve. "Pa diskutim nuk bëhet fjalë që ata të lënë punë atje dhe të vijnë këtu me sy mbyllur, por bëhet fjalë për t'i nxitur që të investojnë kursimet e tyre në funksion të këtij projekti, ku secili do të marrë përfitimin e vet", - tha Rama.

Busti i Arbnorit, Manjani: E kanë shëmtuar. Balla: E zgjodhi PD në 2007

Ish-ministri i drejtësisë Ylli Manjani e cilësoi dje, të shëmtuar bustin që i kanë ngritur ish-kryeparlamentarët Pjetër Arbnori para parlamentit. Një ditë pas përfundimit, Manjani tha se "Realisht e kanë shëmtuar figurën dhe imazhin e Pjetër Arbnorit që ishte një njeri i madh, me shumë vlera, që nuk e meritonte të ndërronte jetë. Po të doni ta krahasojmë me këta që janë sot, këta janë faqja e zezë, janë shumë vite dritë larg. Është e njëjta gjë si busti i Fan Nolit". Pas kësaj, kryetari i grupit parlamentar të PS-së, Taulant Balla reagoi e tha: "Në vitin 2007, një vit pas ndarjes nga jeta të zotit Arbnori, Ministria e Kul-



turës hapi një konkurs për punimin e një busti në nderim të ish-kryeparlamentarit Pjetër Arbnori, konkurs që shpalli si fitues pikërisht bocetin e skulptorit Sadik Spahia. Pra, para 11 vitesh. Por busti



nuk u vendos dot për 11 vite. Pse nuk u vendos, pse u la në harresë? Nuk dua të bëhem pjesë e këtij debati. E rëndësishme është se busti u bë dhe u vendos më 19 korrik 2018".

tetjetje e drejtpërdrejtë për ata që investojnë në agroturizëm, që nga 5 milionë deri në 100 milionë, flas me të vjetra, si bashkëfinancim. Këtu nuk bëhet fjalë për kredi. Këtu bëhet fjalë për grant, për para që jepen për projektin pa asnjë interes nga ana e qeverisë. Numri i projekteve që kemi marrë ka qenë 10 herë më i vogël se numri i bashkive që kemi. Kjo është e pa-

kuptueshme dhe e pajustifikueshme dhe tregon sa larg akoma janë bashkitë e reja nga vëmendja që duhet të kenë ndaj pjesës së fshatit", - u shpreh kryeministri. Kreu i qeverisë tha se "është për të ardhur keq që i gjithë diskutimi i kryetarëve të bashkive, kur vjen puna tek fshati, është "rrugë-rrugë-rrugë". Rrugët janë të domosdoshme, por edhe

mundësia për të investuar në rrugët rurale është e kufizuar, mund të investohet, aq sa mund të investohet. Ndërkohë që ka shumë elementë të tjerë që mund të shkojnë paralelisht dhe ka shumë raste konkrete që parësishet se rrugët mund të mos jenë në nivelin e duhur, investimet në agroturizëm sjellin sukses", - u shpreh Rama, më tej.



EKSPOZITA

Kryeministri shqiptar Edi Rama ishte dje, në Salento të Italisë si i ftuar i nderit në eventin e rëndësishëm "Çmimi i kulturës Pio Alferano" organizuar çdo vit në komunën e Castellabate në rajonin e Kampanjës. Nën kurimin e kritikut të njohur të artit Vittorio Sgarbi, kryeministri Edi Rama merr pjesë në këtë event kulturor me ekspozitën e tij retroprospektive të titulluar "Karakter i fortë, shpirt i sjellshëm; Edi Rama."

Diplomohen 43 kadetë të rinj, Xhaçka: Nuk do të jenë vetëm oficerë me armë, por financiarë, mjekë, pedagogë

Ushtria shqiptare do të ketë nga dje, 43 oficerë të rinj. 43 kadetë të KPOR (Kursit të Përgatitjes së Oficerëve të rinj) u diplomuan gjatë një ceremonie, ku e pranishme ishte ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka, deputetë të Komisionit të Sigurisë, ushtarakë e familjarë të të rinjve. Gjatë fjalës përshëndetëse ministrja Xhaçka bëri të qartë se këta të rinj të sapodiplomuar nuk do të jenë thjeshtë 43 emra më shumë në organikat e Forcave të Armatosura, por do të jenë 43 vajza dhe djem, të gatshëm për të qenë liderët e ardhshëm të FA, për të promovuar profesionalizëm, disiplinë dhe përkushtim ndaj një kombi të tërë. Ministrja Xhaçka bëri të ditur se studimi në akademi të tilla u jep mundësi të rinjve të kthehen më pas përfaqësuesit më të denjë të Shqipërisë krahas mijëra efektivëve nga vendet aleate të familjes së madhe euro-atlantike. Duke iu drejtuar prindërve të 43 kadetëve të sapodiplomuar, ministrja e Mbrojtjes tha: "Shumë prej jush, me të drejtë mund të ngrenë pikëpyetje mbi të ardhmen e fëmijëve tuaj, të sapo diplomuar si oficerët më të rinj të ushtrisë shqiptare. Ju siguroj se secili prej jush duhet të ndihet krenar për vajzat dhe djemtë tuaj nën uniformë, kur t'i shikoni ata, duke përfaqësuar vendin në vendet anëtare të NATO-s. Kam këtu parasysh, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, përfaqësitë tona diplomatike, përfaqësimin në komandat e aleancës në Bruksel, apo në Northfolk, apo dhe në misionet e ndryshme të paqes për të përcuruar vlerat më të mira të forcave tona të armatosura. Do të jeni krenarë për fëmijët tuaj jo vetëm si oficerë me armë por edhe si financiarë, si pedagogë, si mjekë, si juristë, si komandantë, si pilotë, si detarë, të ardhshëm, pse jo edhe si gjeneralë apo si shefa shtabi".





Kreu i PD: S'ka bashkëqeverisje me Ramën, amendojmë ligjin antimafia

Paralajmërimi i Bashës: Mina kundër kullave pranë Teatrit

"Nëse i vini minat godinës, do t'ua vëmë kullave tuaja"

Valentina Madani

Kreu i PD-së, Lulzim Basha, paralajmëroi dje se kalimi i ligjit për Teatrin Kombëtar është shpallje lufte dhe se opozita do i përgjigjet po me luftë. Sipas Bashës, ky ligj është atentat ndaj lirisë të qytetarëve dhe u bëri thirrje ndërkom-bëtarëve që të reagojnë për shembjen e godinës. Basha akuzoi drejtpërdrejt kryeministrin Edi Rama se po realizon ëndrrën e tij 20-vjeçare me këtë projekt, që Basha e etiketoi si "mafioz", pasi me këtë ligj po favorizon kompaninë private për afëra korruptive. Basha ashpërsoi tonet kur tha se nëse mazhoranca socialiste kalon ligjin që i "vë minat" godinës së teatrit, atëherë opozita do t'u vendosë minat kullave, që sipas kryedemokratit do ndërtohen në truallin e teatrit. I rreshtuar në krah të kauzës së aktorëve për mbrojtjen e godinës së Teatrit Kombëtar, Basha paralajmëroi fort: "Nëse guxonin t'i vini minat Teatrit Kombëtar, të jeni të sigurt që minat do t'ua vëmë dhe kullave tuaja me ligj. Nuk ka shans të gëzoni frytet e një ndërmarrjeje të tillë kriminale! Çdo veprim i 'Fusha sh.p.k.' dhe çdo entiteti tjetër do të jetë subjekt i ligjit të amenduar 'antimafia'. Do të nisim që ditën e parë të biznesit dhe në bazë të ligjit antimafia, do ju sekuestrojmë çdo centimetër katror dhe çdo cent, qindarkë, euro për shkeljet që do të konstatojmë. Nëse kryetalebani dhe aksesorët e tij në këtë krim nuk tërhiqen, do i përgjigjem me luftë totale. Nëse i vini minat Teatrit Kombëtar, do u vëmë me ligj minat edhe kullave tuaja". Kritika pati edhe për ndërkom-bëtarët, të cilët i ftoi të reagojnë lidhur me atë, që opozita e cilëson afërë kriminale. "E habitshme sesi nuk pati një reagim nga Këshilli i Europës, nuk foli as OSBE në Tiranë", deklaroi kreu i PD-së. Basha akuzoi se: "Edi Rama dhe lakejtë e tij janë sulur për të shkuror kompleksin e teatrit me të gjithë historinë e tij. Tentativa për këto kulla është marrë para 20 vitesh, kur Edi Rama ishte ministër Kulture, se duhet t'u themi 18-vjeçarëve që Edi Rama ka 20 vite në politikë. Nuk ka hequr dorë dhe prej ditës së parë në karrigen e kryeministrin, ka hedhur hapat për realizimin e ëndrrës së tij. Është projekt mafioz se fiton para, do fitohen 205 milionë euro", tha z.Basha.



Kreu i PD-së, Lulzim Basha

Berati dhe Tirana i jep Kitaroviçit "Çelësin e Qytetit"

Presidentja kroate viziton Krujën, flet për lidhjen e Skënderbeut me Kroacinë

Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj priti dje presidenten kroate, Kitaroviç, sipas Bashkisë së Tiranës, palët diskutuan për rritjen e bashkëpunimit mes Tiranës dhe qyteteve kroate, si dhe mundësitë e shkëmbimit të eksperiencave pozitive. Ndërsa Kitaroviç u shpreh e impresionuar pozitivisht nga ndryshimet e Tiranës. "U shpreh edhe më herët për median kroate, sa e surprizuar jam me ndryshimet që pashë në Tiranë. Që prej vizitës sime të parë këtu në 1963, pashë se sa ka ndryshuar qyteti", tha Kitaroviç. Për të ftuarit, miqtë e Tiranës nderohen me çmimin "Çelësi i Qytetit". Ndërsa kreu i shtetit, Ilir Meta publikoi disa foto nga vizita në Berat, ku shoqëronte Presidentin e Kroacisë, Kolinda Grabar-Kitaroviç, e cila sot mori edhe titullin "Qytetar Nderi". "Qytetarja më e re e qytetit të lashtë të Beratit, Presidentja e Kroacisë, Kolinda Grabar-Kitaroviç, Qytetare e Nderit e vendit të ikonografit të famshëm mesjetar Onufri, e qytetit të një mbi një dritareve dhe



Presidentja e Kroacisë, Kolinda Grabar-Kitaroviç, dje në Krujë

perlës së trashëgimisë botërore të UNESCO-s", shkruan Meta në "Facebook". Më herët presidentja kroate takoi kreu e opozitës, Lulzim Basha, i cili e cilësoi të rrezikshme për paqen dhe stabilitetin idetë për shkëmbime terriroresh, të cilat sipas tij çojnë drejt hapjes së 'kutisë së Pandorës'. Gjatë takimit me presidenten kroate, Basha vuri në dukje nevojën e Shqipërisë për të marrë nga Kroacia ndihmë për procesin e integritimit evropian, duke theksuar se sfidat kryesore për Shqipërinë janë shteti ligjor; zgjedhjet e lira dhe të ndershme, lufta

kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe sistemi gjyqësor i pavarur dhe funksionues në të gjitha shkallët. Kitaroviç vizitoi qytetin e lashtë të Krujës në ditën e tretë të qëndrimit në Shqipëri. Gjatë vizitës në kalanë e famshme, ajo vuri re lidhjet e hershme historike të miqësisë mes dy vendeve dhe popujve, duke nënvizuar faktin se Heroi ynë Kombëtar, Gjergj Kastrioti dhe i biri, Gjoni, u shpallën "Qytetarë Nderi" të Republikës së atëherëshme të Raguzës (Dubrovniku i sotëm).

drërsë së tij. Është projekt mafioz se fiton para, do fitohen 205 milionë euro". Në kushtet kur vendi sipas kreu të demokratëve po kalon një krizë të rrethështë, politike, kushtetuese dhe morale, çdo bashkëpunim me mazhorancën, qoftë ky edhe për amendimin e ligjit që u

hap rrugë prurjeve në shkollën e magistraturës është i pavlerë. "Bashkëpunim me Ramën nuk ka", theksoi z.Basha. I pyetur për afrimin e të larguarve nga PD, pas takimit të së enjtes në selinë blu me dy prej kritikëve të tij, Ruli e Mustafaj, Basha tha se dora e tij është shtr-

irë për bashkëpunim me këdo. Aleatët, të cilët i kërkojnë ndryshimin e sistemit zgjedhor dhe lista të hapura me amendimet e reja që pritet t'i bëhen ligjit elektoral nga komisioni Ad Hoc, kreu i demokratëve i garanton se të gjitha opsionet do jenë pjesë e diskutimeve.

AKUZA

"Tentativa për këto kulla është marrë para 20 vitesh kur Edi Rama ishte ministër Kulture, se duhet t'u themi 18-vjeçarëve që Edi Rama ka 20 vite në politikë. Nuk ka hequr dorë dhe prej ditës së parë në karrigen e kryeministrin, ka hedhur hapat për realizimin e ëndrrës së tij. Është projekt mafioz se fiton para, do fitohen 205 milionë euro", tha z.Basha.

"Magjistratët", PS kërkon votat e LSI-së

Kryemadhi, mazhorancës: Mjaft u lodhët me kafe, vendimin nuk e marr vetëm

Pas braktisjes së punimeve të seancës plenare nga ana e deputetëve të PD-së, kryetari i grupit të PS-së, Taulant Balla i përsëriti thirrjen LSI-së për të bashkuar votat me mazhorancën për miratimin e ligjit, që u hap rrugë emërimeve të reja në drejtësi. Thirrjes së Ballës i është përgjigjur kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi në "Facebook", në të cilin shkruan se këtë situatë, ata e kishin konstatuar vite më parë. Sipas Kryemadhit, partia e saj nuk merr vendime të tilla, të pa harmonizuara me partitë e tjera në opozitë dhe nëse qeveria do të kontribuojë në zgjidhjen e ngërçit, duhet të ftojë të gjitha partitë e opozitës. "Qeveria e mazhoranca moniste duhet të kuptojë se është përgjegjëse e drejtpërdrejtë e lënies së vendit pa gjykata. As regjimi i Kim Jong nuk ia ka bërë këtë gjëmë vendit të vet. Në princip ne nuk bashkëpunojmë me këtë mazhorancë moniste, aq më tepër jashtë tryezës politike pozitive-opozitive. E kanë kot që lodhen nëpër kafene, edhe më të kotë që fabrikojnë lajme për takime jo-institutionale me opozitën. Dialogu politik është institucion, jo Pazar!", tha zj.Kryemadhi. Ajo i kujton PS-së se: "LSI është parti në opozitë me monizimin dhe Rilindjen! Si e tillë, ajo nuk merr vendime të tilla e vetme dhe të paharmonizuara me partitë e tjera në opozitë. Nëse qeveria moniste do vërtet të kontribuojë në zgjidhjen e kësaj katrahure demokratike, duhet të na ftojë, jo në si individë, por partitë e opozitës në tryezën e dialogut politik".

REAGIMI

"Qeveria e mazhoranca moniste duhet të kuptojë se është përgjegjëse e drejtpërdrejtë e lënies së vendit pa gjykata. As regjimi i Kim Jong nuk ia ka bërë këtë gjëmë vendit të vet. Në princip ne nuk bashkëpunojmë me këtë mazhorancë moniste, aq më tepër jashtë tryezës politike pozitive-opozitive. E kanë kot që lodhen nëpër kafene, edhe më të kotë që fabrikojnë lajme për takime jo-institutionale me opozitën. Dialogu politik është institucion, jo Pazar!", tha Kryemadhi.

DENONCIMI

PD denoncoi dje kryebashkiakun Erion Veliaj, teksa përmes zëdhënësës së selisë blu, Ina Zhupa thuhet se, "bashkia i ka dhënë tenderin për 'uniformat e policisë bashkiake' një biznesi nën sekuestro dhe me 1 të vetëpunësuar".

Ministrat e Jashtëm të Evropës, mbledhen në tetor në Tiranë

Negociatat me BE, ambasadori austriak: Do punojmë shumë ngushtë me Shqipërinë

Sattler: Kalendari 6 mujor i presidencës austriake

Ministrat e Jashtëm të Evropës do të mbledhen në tetor në Tiranë si një prej trezave që do të organizohen në kuadër të presidencës austriake të Bashkimit Evropian me fokus integrimin, stabilitetin dhe sigurinë e rajonit të Ballkanit dhe të gjithë Unionit! Ambasadori Johann Sattler ndërsa prezantoi tri prioritetet e presidencës 6 mujore, vlerësoi reformat e Shqipërisë dhe rikonfirmoi mbështetjen për integrimin. Shqipëria do të mirëpresë në tetor takimin e ministrave të Jashtëm të Evropës dhe disa treza e të tjera që do të kenë në fokus integrimin dhe stabilitetin e rajonit. Aktivitetet do të jenë pjesë e kalendari 6 mujor të presidencës austriake të Bashkimit Evropian të shpallura në Berat nga ambasadori Johann Sattler, i cili vlerësoi edhe vendimin për negociatat me Shqipërinë. "Kemi Konferencën Ministeriale dhe për ne është një sinjal që perspektiva e anëtarësimit për Shqipërinë dhe Ballkanin Perëndimor është reale.



Ambasadori Johann Sattler

Në tetor kemi konferencën e ministrave të Jashtëm të Evropës në Tiranë. Me Shqipërinë do të punojmë shumë ngushtë që faza përgatitore për çeljen e negociatave të shfrytëzohet intensivisht". Në shpreh ambasadori i Austrisë në Tiranë, Johann Sattler. Diplomati tha se tri do të jenë prioritetet e presidencës austriake të Këshillit të Bashkimit Euro-

pian "Së pari është siguria dhe lufta kundër emigracionit të jashtëligjshëm; së dyti, ruajtja e prosperitetit dhe konkurrencës në BE nëpërmjet dixhitalizimit dhe së treti, ruajtja e stabilitetit në Europë. Këtu flasim për perspektivën e anëtarësimit në BE të vendeve të Ballkanit Perëndimor, përfshi edhe Shqipërinë", -tha Sattler. Diplomati vlerësoi

PRIORITETET
Diplomati tha se tri do të jenë prioritetet e presidencës austriake të Këshillit të Bashkimit Evropian "së pari, është siguria dhe lufta kundër emigracionit të jashtëligjshëm, së dyti, ruajtja e prosperitetit dhe konkurrencës në BE nëpërmjet dixhitalizimit dhe së treti ruajtja e stabilitetit në Europë. Këtu flasim për perspektivën e anëtarësimit në BE të vendeve të Ballkanit Perëndimor, përfshi edhe Shqipërinë", - tha Sattler

reformat e ndërmarra nga Shqipëria dhe rikonfirmoi mbështetjen e Vjenës zyrtare për integrimin e Shqipërisë në BE. Austria mori në datën 1 korrik 2018 Presidencën e Këshillit të Bashkimit Evropian, për herë të tretë mbas atyre të viteve 1998 dhe 2006. Presidencën austriake qëndron nën moton "Evropa, që mbron".



Mbledhet grupi parlamentar "Miqte e fëmijëve"

Ruçi: Gjendja e pashtetësisë së fëmijëve në alarm, trajtim në Kuvend

Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, z. Gramoz Ruçi, thirrri dje mbledhjen e grupit parlamentar "Miqte e fëmijëve", e cila shqyrtoi raportin "Mbi gjendjen e pashtetësisë në Shqipëri". Në fjalën e tij në këtë aktivitet, Kryetari i Kuvendit, Ruçi u shpreh se qëllimi është avancimi i agjendës për trajtimin e çështjeve të fëmijëve, në Kuvendin e Shqipërisë dhe plotësimi i detyrave që rrjedhin nga plani i punës dhe kalendari i veprimtarive të grupit. Ruçi u bëri thirrje deputetëve që pjesëmarrja në këtë grup duhet të konsiderohet jo vetëm një përgjegjësi dhe angazhim njerëzor, shoqëror dhe moral, por një detyrë e mirëfilltë politike dhe institucionale, për të cilën duhet të punojmë më shumë. Për regjistrimin e fëmijëve, bëri thirrje Z. Ruçi, duhet të jemi të gjithë dhe gjithmonë në alarm. Në fund të muajit shtator do të thërras mbledhjen e grupit "Miqte e fëmijëve" për të diskutuar realizimin e detyrave që caktuam sot.

Takim trepalësh i ministrave të Jashtëm të Shqipërisë, Kroacisë, dhe Malit të Zi

Bushati: Procesi i zgjerimit nuk mund të zhvillohet në vakum



hati "procesi i zgjerimit nuk mund të zhvillohet në vakum, duhet të shoqërohet me instrumente që i shërbejnë dhe procesit të rimbëmbjes

së ekonomisë dhe transformimit politik dhe shoqëror të vendeve të Ballkanit Perëndimor". Duke vlerësuar politikën e dyerve të

hapura të NATO-s, ministrat shprehën mbështetjen e plotë për anëtarësimin e Maqedonisë në Aleancë dhe vlerësuan marrëveshjen mes Shkupit dhe Athinës si dialogun Kosovë-Serbi. Një fokus i veçantë ju kushtua ecurisë dhe ndërveprimin për avancimin e projekteve me rëndësi strategjike si Korridorin Adriatiko-Jonian dhe Gazsjellësi që do lidhë linjën Trans-Adriatik me Kroacinë nëpërmjet Shqipërisë, Malit të Zi dhe Bosnjës Hercegovinës, por edhe bashkëpunimit në fushën e energjisë, turizmit dhe mjedisit.



Emergjencat civile, Meta: Bashkëpunim me Kosovën në rastin e fatkeqësive natyrore

Presidenti i Republikës, Ilir Meta priti dje, në një takim Bejtush Gashi, ministër i Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës. Presidenti Meta shprehu kënaqësinë e veçantë për rekomandimin pozitiv që Komisioni Evropian, ka dhënë për liberalizimin e vizave për qytetarët e Republikës së Kosovës, dhe pret me kënaqësi që edhe Parlamenti Evropian dhe Këshilli të miratojnë sa më parë këtë rekomandim, që qytetarët e Republikës së Kosovës më në fund të lëvizin të lirë në shtetet e Bashkimit Evropian. Presidenti Meta theksoi rëndësinë që ka bashkëpunimi mes dy vendeve tona, por edhe shteteve të tjera të rajonit, në luftën kundër terrorizmit dhe krimit të organizuar, si dhe krijimin e një klime sa më të mirë dhe të sigurtë për të gjithë rajonin tonë. Presidenti Ilir Meta, në mënyrë të veçantë u interesua për bashkëpunimin mes dy shteteve tona në fushën e Emergjencave Civile dhe falënderoi ministrin Gashi për angazhimin profesional të pjesëtarëve të Emergjencave Civile të Kosovës me rastin e fatkeqësive të ndryshme natyrore në vendin tonë, por edhe në rajon. "Bashkëpunimi në fushën e Emergjencave Civile, duhet të jetë prioritet i të gjithë neve, jo vetëm në Shqipëri dhe Kosovë, por edhe me shtetet e tjera të rajonit", - theksoi Presidenti Meta.

SHPLLALLE ANKANDI
Datë 24.07.2018, Ora 16:00
Shoqëria Përmbarrimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë Rr. "George W. Bush", Pallati "Kasmi", Zyra 107, Tiranë. Tel. 404506426, Cel. 067 201 9460/ 068 904 9202, e-mail: besnik.bajraktari@gmail.com
Shpall ankandin e parë për pasurinë e pajalshme të debitorit Enkeleza Novaku dhe dorëzansit Adriatik Novaku.
"Triull" me sipërfaqe 100 m2 dhe "Ndërtësa" me 3 kate me sipërfaqe 90 m2 secili, 2 kate të miratuara me Vendim për Leje Ndërtimi Nr. 22 datë 29.04.1996 të Këshillit Bashkiak Pogradec, nr. i pasurisë 4/106, zona kadastrale 8581, vol. 13, faqe 69, adresa: Lagja Nr. 1, Pogradec.
Çmimi fillestar i ankandit të parë është në shumën 10 400 000 (dijetë milionë e katërqind mijë) lekë.
Ankandi do të zhvillohet në ambientet e Shoqërisë Përmbarrimore "Besnik Bajraktari" sh.p.k me adresë: Rr. "George W. Bush", Pall. Kasmi, Zyra 107, Tiranë

Përmbarruesi gjyqësor Genti Bushati nxjerr për shitje në ankand pasurinë :
"Toke Are me sipërfaqe 865 m2, me Nr pasurisë 131|86 Zona kadastrale nr 1896, Votumi 9, faqe 44 , me vendndodhje Grude e re Shkoder .
2. Çmimi me të cilin do të fillojë shitja në Ankand për pasurinë e sipërpershkruar , është në vlerën 302,400 (Treqind e dy mijë e katërqind) Lekë .
Shitja e pasurisë do të bëhet (zhvillohet) me datë 27.07.2018 ora 16.16 në Zyrën e përmbarruesit gjyqësor Genti Bushati me adresë Rruga Don Bosko , Përballë Gjykatës së rrethit Gjyqësor Shkoder. Personat e interesuar duhet të derdhen përpara fillimit të ankandit 10 % të vlerës si garanci në Bankën BKT dega Shkoder me nr llogarie 41064051.

Kreu i ALUIZNI-t, Artan Lame: Banesat e ndërtaura para vitit '91 do të marrin dokumentin e pronësisë

Ornela Manjani

Qeveria ka miratuar një vendim, i cili synon të zhblokojë ngërçin e pronësisë për banesat e ndërtaura para vitit 1991. Drejtori i ALUIZNI-t, Artan Lame shpjegoi se çfarë hapash duhet të ndjekin qytetarët për të marrë dokumentin e pronësisë. Aktualisht janë rreth 60 mijë banesa të ndërtaura para vitit 1991, për të cilat pronarët nuk kanë mundur të marrin dokumentin e pronësisë, duke përfshirë edhe banesat në lagjet mesjetare të qyteteve si Berati, Gjirokastra apo Shkodra. Sipas Lames, arsyeja për këtë ngërç ka qenë neglizhenca e institucioneve, mungesa e dokumentacionit nga pronarët, por edhe procedurat burokratike. Duke filluar nga shtatori, të gjithë pronarët e këtyre banesave duhet të aplikojnë për marrjen e pronësisë në sportelet e ALUIZNI-t. Sipas Lames, këta qytetarë duhet të dorëzojnë të gjithë dokumentet që zotërojnë dhe më pas e gjithë procedura deri në dhënien e pronësisë do të kryhet nga vetë ALUIZNI.

Tapi për 60 mijë shtëpi, Lame: Dokumentet dhe procedurat


Certifikata pronësie për ndërtesat e vjetra, aplikimet nisin në shtator



Drejtori i ALUIZNI-t, Artan Lame

Çfarë duhet të bëjnë qytetarët?

Duke filluar nga shtatori, të gjithë qytetarët e interesuar për regjistrimin e banesave të tyre të ndërtaura përpara vitit 1991 do të mund të paraqiten pranë sporteleve tona për të aplikuar. Ndërkohë, mund të fillojnë nga grumbullimi i dokumentacionit që ata posedojnë, leje ndërtimi të vjetra, akte pronësie, skica genplane, akte shitblerjeje apo posedimi, vendime të vjetra të Këshillave Popullore, apo dokumente të tjera provuese të çdo lloji dhe kohe. Zbatimin e këtij vendimi dhe gjithë procedurën përkatëse, qeveria ia ngarkoi ALUIZNI-t, qoftë për shkak të rrjetit ekzistues të punonjësve në terren, qoftë për shkak të eksperiencës operative dhe teknike të akumuluar nga ana e specialistëve tanë. "Këtë funksion të ri ne e shohim edhe si besim të qeverisë tek rezultatet e deritanishme të arritura prej gjithë këtij kolektivi punonjës", tha Lame. Zbatimin e këtij vendimi do të kryejnë mundësinë e mijëra pronarëve që përmes regjistrimit të pronës së tyre, të mund ta bëjnë atë të garkullueshme në treg, ta shesin apo ta japin me qira ligjërish, ta fusin në tregun e pasurive të paluajtshme, apo ta trajtojnë në tregun e kredimarrjes. "E kemi thënë që në fillim të mandatit të kaluar qeverisë së zgjidhja dhe stabilizimi i çështjes së pronësisë është një nga çështjet kyçe për qetësimin e gjithë shoqërisë shqiptare dhe zhvillimin e ekonomisë", deklaroi kreu i ALUIZNI-t.



PËRCAKTIMI I SIPËRFAQES

Në përcaktimin e sipërfaqes, ALUIZNI bazohet në kufijtë faktikë të sipërfaqes së poseduar, pa tejkalluar masën prej 300 metrash katrorë.

1. Për procedurën e ndjekur, subjekti përfitues paguan për llogarit të ALUIZNI-t tarifën e shërbimit, në vlerën 8 000 lekë për çdo kat ndërtimi, e cila përdoret për të përballuar shpenzimet e evidentimit në terren dhe shpenzimet e tjera të procedurës administrative. Kjo tarifë i njohetohet përfituesit menjëherë pas përfundimit të periudhës së afishimit, nëse përbushen kushtet për të përfituar kalimin e pronësisë, sipas këtij vendimi.

2. Vendimi për kalimin e pronësisë miratohet në favor të subjektit kërkues dhe bashkëshortit/es së tij, duke respektuar dispozitat e Kodit të Familjes për regjimet pasurore martesore. Në rast se subjektet nuk paraqesin dokument që provon regjimin pasurore martesor të veçantë apo marrëveshje të posaçme noteriale për të drejtat mbi ndërtesën, vendimi miratohet në favor të të dy

bashkëshortëve, duke prezumuar regjimin e bashkësisë ligjore. Për zbatimin e kësaj pike, ALUIZNI administron certifikatën familjare të kërkuesit, sipas mënyrës së përcaktuar në vendimin nr.332, datë 17.3.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e formës, të elementeve përbërëse, mënyrës së mbajtjes e afatit të përdorimit të dokumenteve bazë, që mbahen dhe lëshohen nga shërbimi i gjendjes civile", të ndryshuar. Vendimi për kalimin e pronësisë miratohet brenda 20 ditëve nga administrimi i vërtetimit për pagesën e tarifës së shërbimit, por në çdo rast, jo më herët se data e përfundimit të afatit të njohimit publik.

3. ALUIZNI brenda 10 ditëve nga miratimi i kalimit të pronësisë përcjell vendimin, së bashku me genplanin, për regjistrim pranë ZVRPP-së, e cila është e detyruar të kryejë regjistrimin brenda 10 ditëve nga administrimi i dokumentacionit.

regjistrimit të banesave në vitin 1995. Kjo u bë asokohe me vendimin nr. 432 datë 14.08.1995 "Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në zonën urbane të fshatit". "Ky vendim

është aplikuar në atë kohë në masë minimale në disa zona rurale dhe sikurse kuptohet nga vetë titulli, nuk e trajtonte problemin për të gjithë territorin e vendit, por ofronte një zgjidhje të

pjesëshme vetëm për fshatrat. Më pas është vijuar me VKM 608 datë 05.09.2012, i cili gjithashtu nuk e ka realizuar dot qëllimin e tij gjatë këtyre gjashtë viteve. Arsyent e dështimit të këtyre dy

vendimeve të kaluara lidhen së pari me mungesën e kapaciteteve njerëzore, por në shumë raste edhe të vullnetit, apo neglizhencën e njësive të qeverisjes vendore, të cilat kanë qenë organet e ngarkuara me kryerjen e këtyre procedurave. Së dyti, për sa i përket VKM nr. 608/2012, shkaqet lidhen edhe me burokratizimin e tepruar të procedurës dhe mbi të gjitha me qasjen jorealiste ndaj problemit", - thotë Lame.

APLIKIMI

Lehtësimi i barrës së aplikuesit nga detyrimet dhe dokumentacioni i tepërt, (aplikuesi tanimë do të duhet të paraqesë vetëm kërkesën pranë ALUIZNI-t). Zgjidhja e të gjithë pamundësisë së deritanishme, për të provuar periudhën e ndërtimit (para datës 10.8.1991), gjë që ka penguar finalizimin e procedurës dhe

kalimi i pronësisë së trualit të ndërtesës falas deri në 300 metra katrorë, si dhe mundësia për të blerë sipërfaqet mbi këtë masë janë tri risitë që parashikon vendimi. Lame evidentoi se numri i ndërtimeve që mendohet të trajtohen nga ky vendim është 40-60 mijë. "Duket theksuar - tha ai - se asnjëherë nuk është bërë një evidencim i plotë dhe i saktë i këtyre objekteve dhe si rrjedhim shifra reale mund të jetë edhe më e lartë se ajo e mësipërme. Dy muajt në vazhdim do të bëhet organizimi i stafëve për të krijuar pranë secilës drejtorie rajonale të ALUIZNI-t nga një sektor që do të merret ekskluzivisht me ndjekjen dhe zbatimin e kësaj VKM-je. Gjithashtu, do të përzgjedhim edhe stafet rajonale që do të merren me mbarëvajtjen e këtij procesi.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
Zyra përbarimorë "Best 2010"

SHPALLJE ANKANDI

Më datë 17 gusht 2018 nga ora 08.00-ora 16.00 tek zyrë përbarimorë do zhvillohet ankandit për shitjen e pasurisë nr.58/56, vol 17, fq 3 të ndodhur në L.13, ZK 8518, Plazh. Durrës. Trualit që ka sipërfaqen prej 600 m² ku zhvillohet sipas një marrëveshjeje sipërmarjeje.

Prona është e vëllëzërve, z.Arben e z.Shkëlqim Riza Brameta

Cmimi fillestar me të cilin hapet ankandi do të jetë 54150000 lek.

Cmimi mund të llogaritet edhe në euro sipas kursit të këmbimit ditor.

Oftuesit duhet të kenë dispozitat në llogarinë e zyrës përbarimorë 10% të cmimit fillestar.

Adresa: L. 2, prapa Prokurorisë së Rrethit Durrës. Tel/Fax: 052-22-6000
E-mail: best.2010@perbarues.al, web: www.perbarues.al

NJOFTIM ANKANDI

Shoqëria përbarimorë "BALIFF SERVICE E. HOXHA" shpk njofton shpalljen e ankandit të III-të, për shitjen e pasurive të llojt:

- Arë, me sip. 1.400 m², ZK 3235, ndodhur në Rogozhinë Fshati Bishti i Zhurit, në pronësi të z.Ernold Luan Meka. Ankandi i pasurisë filloi me cmimin fillestar në vlerën 564,400 (pesëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e katërqind e tetëdhjetë) Lekë.


- Arë, me sip. 1.485 m², ZK 3235, ndodhur në Rogozhinë Fshati Bishti i Zhurit, në pronësi të z.Ernold Luan Meka. Ankandi i pasurisë filloi me cmimin fillestar në vlerën 598,752 (pesëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e dy) Lekë.

Ankandi do të zhvillohet më datë 24.07.2018, ora 16:00, pranë zyrës së Shoqërisë Përbarimorë "BALIFF SERVICE E HOXHA" shpk, në adresën Rruga "Vaso Pasha" Pallati 13/1, Ap.1, Tiranë, nr.telëfon 0682029920, email: elvith@hotmail.com.

SHPALLJE ANKANDI

Zyra Përbarimorë "E.G Baillif Service" me përbarues Enuar Merko me adresë Rr Ibrahim Rruva, Pall.64, Hyrja B, Ap.1, Tiranë, njofton se me datë 10.08.2018 ora 9^h - 16^h ne angjantet e saj, do të zhvillohet: Ankandi II për shitjen e pasurive të paluajtshme Trualit me sipërfaqe 24.405.50 m² e ndodhur në rrugën "Ali Shefqet", Tiranë me Nr.pasurie.9/609, Volumi.20, Faqe.6, në pronësi të Shoqërisë BAU-CONSTRUCTION sh.p.k me vlerë fillestare në ankand 341.676.72 (Treqind e dyzet e një mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e gjashtë pikë shtatëdhjetë e dy) EURO .

Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit 0672027580, 355 4 22 31 888. email enuar.merko@gmail.com



ANNOUNCEMENT

Private Vocational Training Providers – Call for (i) Expressions of Interest and (ii) Proposals

The GIZ Program for "Sustainable Economic and Regional Development, Employment Promotion and Vocational Education and Training" in Albania (GIZ ProSEED), implemented on behalf of the German Federal Ministry of Economic Cooperation and Development, under the component of Technical Vocational Education & Training (VET), will cooperate with private vocational training providers in the country with the aim to scale-up VET interventions, complementary to the courses offered by public VET providers.

In this respect, the programme is conducting a Call for (i) Expressions of Interest and (ii) Proposals from **23 July – 20 August 2018**, which shall help to identify private training providers that offer Vocational Training (VT) in line with the requirements below:

- Under each contract, the private training providers, will offer several training courses. The training duration of each course per batch should be at least 1 month.
- The training courses under each contract should target altogether 50-150 young people (19-34 years) in total. 40% of the participants are to be female and 30% are to be returning migrants from EU Member States.
- The courses should reflect the following prioritized sectors: ICT, tourism, agro-processing, textile & footwear and innovative/creative crafts; but are not necessarily limited to these sectors, if justified based on local labour market needs and employment prospects.
- The courses should be demand-driven and include work-based learning based on local labour market needs and eventually aim at employment.
- The proposals should reflect and include information on job placement mechanisms to guarantee employment of minimum 50% of the participants.
- There is no limitation in terms of geographical location, though priority will be given to (rural) locations where public/private vocational training is non-existent or very limited.
- The overall implementation timeframe for the interventions is up to 9 months.

The proposals that are to be selected through this call shall receive financial support ranging between 30,000 – 50,000 EURO (equivalent in ALL). The number of contracts is flexible until the overall programme budget of EUR 400,000 assigned for this activity is allocated.

Selection Procedure:


First step: All (i) Expressions of Interest and (ii) Proposals received by applicants will be evaluated based on the eligibility and technical criteria described in the evaluation grid.

Second Step: The potentially qualified candidates will be invited for interviews and required to submit a budget proposal.

Third Step: Contracts will be awarded to the companies with best technical and financial offer.

Please, send an email to giz-albanien@giz.de, to receive the Proposals format and the Evaluation Grid.

For further questions contact us via email to giz-albanien@giz.de during the period 23 July – 20 August 2018.



Press Notice

To the attention of the general public

Make it in Albania – OPENING OF THE SECOND CALL FOR PROPOSALS

Following its mandate from the German Federal Ministry for Economic Cooperation and Development (BMZ) and in partnership with the Ministry of Economy and Finance (MoEF), the GIZ Program for "Sustainable Economic and Regional Development, Employment Promotion and Vocational Education and Training" in Albania (GIZ ProSEED) under its third component of Social Participation of Marginalized Youth and Minorities is **opening its Second Call for Proposals from 23 July – 21 August 2018**.

The aim of this call for proposals is to financially support local civil society organizations, to implement small-scale projects that strengthen social empowerment and cohesion, and enable the target group to engage actively, in line with their interests and capabilities, to find common solutions to improve their-, and their respective communities' social and economic situations.

All CSOs registered in Albania with at least 2 years of relevant experience and proven record in youth empowerment and social cohesion are invited to submit proposals under this call for proposals.


The 10 envisaged proposals to be selected through this competitive call shall receive financial support in the amount between 10,000 – 20,000 EURs (equivalent in ALL).

The proposed interventions submitted by the local CSOs may take different shapes and may include activities that strengthen the interaction between different groups of youth, activities that contribute to the development of life skills, cultural and sports activities, as well as activities that foster the inclusion of minorities, women, persons with disabilities and migration returnees. The long-term outcome of these activities should aim at increasing the target group's social capital and future employability prospects.

In order to submit a proposal for participation in this call, it is necessary to consult the Application Guidelines that may be obtained by it through the ProSEED Facebook page. The Application Guidelines state the defined objectives, and requirements to be complied with and provide detailed information on the procedures for selection. Interested local CSOs can find all the official templates for submitting proposals under this call annexed to these guidelines. Applying CSOs shall submit their applications only electronically to makeitalbania@giz.de. All applications must be submitted in English language.

For further questions and clarifications on the Application Guidelines, please contact us via email to: makeitalbania@giz.de during the period **16 – 20 of July 2018**, prior to the opening of the call. After this period GIZ ProSEED shall not answer any enquiry related to the call.

The deadline for the submission of the proposals is 21 August 2018, 16:00h.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUCIONI I KOMISIONERIT PUBLIK

NJOFTIM

Institucioni i Komisionerëve Publikë, bazuar në ligjin nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe vendimin e Kuvendit nr. 94/2017, "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Institucionit Komisionerëve Publikë", rishpall vendet vakante për pozicionet:

Përkthyes (paga II-b)

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:

- Të zotërojë diplomë të nivelit Master shkencor në gjuhë të huaja, dega Anglisht ose Drejtësi dhe të ketë minimumi 5 vjet eksperiencë në përkthim shqip-anglisht-shqip.
- Të ketë njohuri shumë të mira në terminologjinë ligjore në të dyja gjuhët.
- Kanë përparësi kandidatët me eksperiencë pune pranë organizatave ndërkombëtare.

Preferohen kandidaturat e licencuara përkthyes zyrtar nga Ministria e Drejtësisë.

Specialist Protokol/Arkiv (IV-b)

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:

- Të zotërojë diplomë të nivelit Master shkencor.
- Të ketë njohuri shumë të mira në gjuhën angleze.
- Të ketë të paktën 3 vite përvojë pune në profesion.

KUSHTE TË PËRGJITHSHME

Kandidatët duhet të sigurohen se plotësojnë kriteret për t'u pajisur me certifikatë sigurie, sipas Vendimit të Këshillit Ministra nr. 188, datë 4.3.2015.

Kandidatët duhet të kenë afësi për t'u përshtatur e punuar në grup, nën presion, si dhe në afate kohore të limituara.

Të gjithë aplikimet duhet të dorëzohen në një nga format e dhëna më poshtë:

- Paraqitjes së kërkesës dorazi nga aplikanti nga data 23 deri 27 korrik 2018, së bashku me dokumentet përkatëse, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" nr. 4, Tiranë, nga e hëna në të premtë, ora: 09:00-16:00.
- Dërgimin e kërkesës së bashku me dokumentet përkatëse, me anë të postës pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" nr. 4, Tiranë. Aplikimi në rrugë postare duhet të kryhet brenda datës 27.7.2018 dhe të vërtetohet me fletëmandatit e lëshuar nga zyra postare.

Në kërkesën që paraqet, kandidati përçakton vendin vakant, për të cilin është i interesuar. Bashkëlidhur me kërkesën, kandidati dorëzon të mbyllura në zarf: 1 kopje të dokumenteve të mëposhtme:

- Jetëshkrimin profesional përshirë të dhënave të kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare.
- Fotokopje e dokumentit të identifikimit (letërnjoftim, pasaportë, kartë identiteti).
- Dokumentet (diplomë, librezë pune, vërtetime, dëshmi, vetëdeklarim, certifikata, trajnime etj.) fotokopje ose të notetruar. Diplomatat që janë marrë jashtë vendit duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.
- Dokument që vërteton se në ngarkim të tij nuk është regjistruar një procedim penal (vërtetim nga Gjykata, vërtetim nga Prokuroria, dëshmi e gjendjes gjyqësore).
- Vërtetim nga institucioni ku punon që nuk ka masë disiplinore në fuqi.
- Një rekomandim nga punëdhënësi.
- Raport që vërteton se është në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme.

Kandidatët që plotësojnë kriteret formale dhe kanë deponuar dokumente të fotokopjuara, përpara intervistës i parashirojnë Komitetit ad-hoc dokumentet e njëjshura ose ato origjinale.



AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE. LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA, ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.



MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ CELULAR SMARTPHONE OSE TABLET



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID



BalkanWeb.com
BW

FALAS



MASA PËR SIGURINË USHQIMORE

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit në vijim të masave për disiplinimin e therjeve dhe të tregtimit të mishit në funksion të sigurisë ushqimore dhe në kuadër të masave të përforcuara gjatë sezonit turistik ka konstatuar tri subjekte në qarkun e Beratit, që tregtonin mish në mungesë të dokumentacionit shoqërues veterinar. Trupa inspektuese e



AKU gjobit tri subjekte me 100 mijë lekë secilin

Drejtorisë Rajonale të AKU, Berat në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme gjatë inspektimit konstatuan kushtet e rënda higjienosanitare në të cilën ushtrohej aktiviteti nga këto subjekte, si mungesë të doku-

mentacionit përkatës, vula dhe certifikata veterinare e produktit. Konkretisht, një subjekt në Kuçovë dhe dy subjekte në Berat, me vepërimentari tregtim mishi, të cilët tregtonin mish keci në mungesë të vulës dhe certi-

fikatës veterinare. Për shkeljet e mësipërme u morën masat administrative bllokimi të produktit 22.3 kg mish keci si dhe masa administrative me gjobë në vlerën 100 mijë lekë për secilin nga subjektet. Autorite-

ti Kombëtar i Ushqimit me qëllim garantimin e sigurisë ushqimore u bënë thirrje konsumatorëve që të jenë të kujdesshëm në blerjen e produkteve shtazore, duke kërkuar informacione në njësitë e tregtimit të mishit që të jetë i vullorur, i shoqëruar me certifikatë veterinare, kuponin tatimor, si mjet për sigurinë e gjurmueshmërisë së produktit.

Ministria e Financave do t'u japë përparësi përfituesve që kanë probleme shëndetësore

Dëmshpërblimi i të përndjekurve politikë, qeveria do ndryshojë ligjin

Pagesë me një këst për raste specifike

Ministria e Financave do të shpërblejë me një këst rastet specifike të ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist. Ky është në thelb ndryshimi ligjor që pritet të bëjë qeveria në ligjin "Për dëmshpërblimin e të përndjekurve politikë", duke përcaktuar një ndarje të re për disa kategori të veçanta. Ministria e Financave dhe Ekonomisë duket se është ende duke finalizuar draftin që do të bëhet publik, por ka bërë me dije paraprakisht se qëllimi i ndryshimeve lidhet me mundësimin e së drejtës ligjore që gëzojnë ish-të përndjekurit e regjimit komunist, të cilët janë ende në jetë dhe bëjnë pjesë në kategorinë parësore, të përfitojnë gjithë shumën e miratuar të dëmshpërblimit financiar, sipas parashikimeve të kuadrit ligjor në fuqi. "Gjithashtu, nëpërmjet këtij projekt akti, synohet edhe përsheptimi i procesit të dëmshpërblimit financiar për familjarët e përndjekurve të burgosur, ekzekutuar dhe të internuar. Ashtu sikurse ligjet e mëparshme amenduese të ligjit nr. 9831/2007, të ndryshuar, edhe ky projektligj synon përmbylljen e procesit të dëmshpërblimit për ata ish-të dënuar që kanë e vuajtur vetë dënimin gjatë regjimit komunist, si dhe familjarëve të tyre nëpërmjet gjetjes së mekanizmeve eficientë", vlerëson Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Injēti institucion bën me dije se objektivi i ndryshimeve është përmbyllja përfundimtare e procesit të dëmshpërblimit për ata ish-të dënuar që kanë vuajtur vetë dënimin gjatë regjimit komunist dhe janë ende në jetë. Së dyti, heqja e raportit të përcaktuar të fondit të miratuar ku 70% i vihej në dispozicion kategorisë parësore dhe pjesa tjetër i shpërndahej kategorisë së trashëgimtarëve. Po kështu do të bëhet dëmshpërblimi i plotë për të gjithë ata ish-të dënuar, të cilët janë ende në jetë, por që për shkak të kufizimeve aktuale të kuadrit ligjor në fuqi, ku përcaktohet ndarja e shumës së dëmshpërblimit në 8 këste, me vlerë maksimale 1 000 000 lekë, nuk kanë marrë të gjithë shumën e miratuar të dëmshpërblimit. Ndërkohë që ekzistojnë subjekte parësore, të cilat e superojnë këtë vlerë (8 x 1 000 000 lekë). Gjithashtu, ky projektligj synon të



trajtojë ato subjekte përfituese, vlera totale e miratuar për të cilët është deri në 1.000.000 lekë, duke krijuar gratë ish-të dënuara që jetojnë në momentin e pagesës. Sipas urdhrorit të Ministrisë së Financave, në kategorinë e dytë me prioritet janë persona ish-të dënuar mbi 75 vjeç në datën e hyrjes në fuqi të

oritare dhe janë përcaktuar dokumentet që duhen plotësuar për çdo kategori përfituese. Të parat në listë janë gratë ish-të dënuara që jetojnë në momentin e pagesës. Sipas urdhrorit të Ministrisë së Financave, në kategorinë e dytë me prioritet janë persona ish-të dënuar mbi 75 vjeç në datën e hyrjes në fuqi të

ligjit, që vazhdojnë të jenë gjallë. Ndërsa në kategorinë e tretë me prioritet janë persona ish-të dënuar politikë të gjallë që vuajnë nga sëmundje të rënda. Për kategorinë e katërt prioritet kanë persona ish-të dënuar që janë gjallë, të cilët pavarësisht moshës, në momentin e pagesës kanë fëmijë të mitur nën moshën 18 vjeç. Ndërsa në kategorinë e pestë prioritet kanë persona ish-të dënuar që nuk jetojnë, por në momentin e pagesës kanë trashëgimtarë të radhës së parë në moshë të mitur nën 18 vjeç. Në kategorinë e gjashtë kanë prioritet persona ish-të dënuar që janë gjallë dhe në momentin e pagesës nuk kanë mbushur 75 vjeç, të cilët duhet të dorëzojnë certifikatë personale jo më e vjetër se një javë nga data e dorëzimit dhe numër llogarie.



Gjiknuri: Reduktohet koha e shërbimit në 20 minuta

Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, Damian Gjiknuri, së bashku me drejtorin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, Arben Isaraj ishin sot në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor për të parë nga afër investimet e kryera në këtë drejtori, me qëllim ofrimin e një shërbimi më të mirë dhe lehtësimin e tij për qytetarët nëpërmjet komunikimit dhe teknologjisë. Drejtoria Rajonale Tiranë, e cila përballon rreth 40% të shërbimit të qytetarëve në rang kombëtar ka përfunduar me sukses rikonstruksionin e sallës së regjistrimit të mjeteve. Kostoja e këtij investimi shkon rreth 12 milionë lekë, e përballuar tërësisht nga buxheti i DPSHTRR. Ky rikonstruksion ka rritur shërbimin në kohë dhe cilësi ndaj qytetarëve duke realizuar zgjerimin e hapësirës të sallës së regjistrimit të mjeteve; rikonstruksionin e ambientit në ndriçim, kondicionimin dhe logjistikën bashkëkohore; shtim të sporteleve që ofrojnë shërbim ndaj qytetarit në masën 50%; krijimin për herë të parë të sallës së pritjes me kushte moderne për qytetarët; krijim të sportelit të informacionit për të sqaruar dhe informuar qytetarët; sistemimin e ambienteve të jashtme duke krijuar mundësi parkimi për mjetet që i nënshtrohen kontrollit fizik apo komisionit të ndryshimeve konstruktive duke shmagur kaosin etj. Drejtori i DPSHTRR, Isaraj theksoi se nuk është investuar vetëm në Tiranë, por edhe në Vlorë dhe po investohet në Elbasan e në Fier. Sipas Isarajt, nëpërmjet këtij investimi kemi një përmirësim të dukshëm në kohë, duke e reduktuar kohën e shërbimit në rreth 20 minuta dhe dyfishimin e numrit të shërbimeve ditore ndaj qytetarëve. "Deri dje është shërbyer në tri ditë, katër ditë, pesë ditë deri një javë. Përfundimisht është zgjidhur edhe një merak që kanë pasur qytetarët, i cili ka qenë krijuar jo për arsye tonën, por për arsye të zgjidhjeve politike të momentit, të cilat kanë krijuar një diferencë 3-mujore në bllokimin e të gjitha llojeve të prokurimeve. Kjo kishte lidhje me atë që i themi në leje drejtimi, patentën. Sot për një muaj kjo drejtori ka prodhuar 40 mijë copë. Ju do t'i shikoni edhe vetë lejet e drejtimit dhe çdo gjë që thuhet, kuptohet nuk ka lidhje me punën tonë, puna jonë është kjo. Fjalët e mira mund të jenë të shumta, por këtë e tregon puna. Z.ministër, një doja ta vlerësoja bashkëpunimin tuaj, por doja të vlerësoja dhe bashkëpunimin me drejtuesit, se kur ka bashkëpunim, çdo gjë arrihet në kohë, në rezultat dhe në produkt."

United Nations Development Programme

TENDER ANNOUNCEMENT

Subject: Request for Quotation - Furniture for Multifunctional Community Centre in Shkodra City

The United Nations Development Programme in Albania is seeking to receive quotations from interested companies who wish to be considered for the provision of the below mentioned furniture's.

Furniture for Multifunctional Community Centre in Shkodra City - ESERE

Companies will be selected in accordance with pre-established UNDP procedures. The offers must be delivered within the deadline set in a sealed envelope and with clearly marked for "UNDP - Economic and Social Empowerment for Roma and Egyptians - ESERE" to the address below.

For more details please refer to the link below:

<http://www.al.undp.org/content/albania/en/home/operations/procurement.html>

Relevant Dates: All interested companies should provide their application in the following address, not later than August 03, 2018, 14.00 hrs.

Any request for Clarifications must be sent to the following e-mail address: procurement.au@undp.org

Address for Communication:

UN House Albania
Str. "Skenderbej", Gurten Building, 2nd Floor
Tirana, Albania
Tel.: + (355) 4 2 276 600
Fax: + (355) 4 2 234448

35-vjeçari nga Lipjani është dënuar nga Krimet e Rënda me 20 vite burg

TIRANË

Interpol Tirana ka ekstraduar nga Kosova një 35-vjeçar të dënuar me 20 vjet burg për "Vrasje me paramendim". Bëhet fjalë për Ahmet Ajetin nga Lipjani, i cili ishte shpallur në kërkim, pasi në vitin 2005 tentoi të vriste në një lokal në Durrës, Lulzim Berishën. "Shtetasi Ahmet Ajeti është shpallur në kërkim ndërkombëtar nga Interpol Tirana më datë, 07.03.2016, pasi Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, Tiranë, me vendimin nr.01 datë 16.01.2012 e ka dënuar me 20 vjet burg për veprat penale "Vrasje me paramendim" dhe "Armëmbajtje pa leje". Si rezultat i bashkëpunimit të Interpol Tirana me Policinë e Kosovës, u bë i mundur arrestimi i tij në Kosovë, duke u finalizuar me ekstradimin e tij drejt vendit tonë", - thuhet ndër të tjera në njoftimin zyrtar të policisë.

ATENTATI I VITIT 2005

Ekstradimi nga Kosova drejt vendit tonë i Ahmet Ajetit sjell në vëmendje ngjarjen e ndodhur 13 vite më parë. Ky i fundit u pagua plot 80 mijë euro që të zhdukte Lul Berishën bashkë me një person tjetër, por një sherr banal dhe një vetëplagosje mbrëmjen e 30 gushtit të 2005-ës bënë që atentati të dështonte. Referuar dosjes rezultojnë se në datën 28.08.2005, të gjykuarit Endrit Dokle dhe Dritan Coli, për realizimin e qëllimit të tyre kriminal, për vrasjen e Lulëzim Berishës, pas konfliktëve që kishin lindur, midis anëtarëve, dikur të së njëjtës bandë, kanë kontaktuar dhe më pas kanë lidhur marrëveshje me dy shtetas kosovarë, me Osman Korpuzin e Ahmet Ajetin. Rezultojnë se këta persona janë takuar në Tiranë dhe u janë treguar të dhëna për të gjykuarin Lulëzim Berishë dhe lëvizjet e tij dhe ata marrin përsipër që ta qëllojnë të gjykuarin Lulëzim Berishë, me armë zjarri të llojit pistoletë. Më pas Korpuzi dhe Ajeti, të shoqëruar nga Sardinian Sulejmani, janë dërguar në qytetin e Durrësit dhe janë sistemuar në hotelin e Asto Hanxharit. Rezultojnë se pas sistemit të tyre në këtë hotel, të gjykuarve Osman Korpuzi e Ahmet Ajeti u janë dhënë dy armë zjarri (pistoleta me silenciator), njëra tip "Zastava" dhe tjetra tip "Uzi", amerikan. Provohet gjithashtu se të gjykuarve Osman Korpuzi e Ahmet Ajeti u është dhënë edhe një fotografi e të pandehurit Lulëzim Berishë. Në datën 30.08.2005, rreth mesditës, të gjykuarit Osman Korpuzi e Ahmet Ajeti, të armatosur janë nisur në drejtim të lokalit, ku qëndronte zakonisht i gjykuari Lulëzim Berishë, me qëllim vrasjen e tij. Së bashku me ta, ka qenë edhe Sardinian Sulejmani, i cili kishte për detyrë të kujdesej për ta derisa të realizonin vrasjen e Lulëzim Berishës. Por, në afërsi të lokalit të shtetasit Lulëzim Berishë, në rrethana jo shumë të qarta, Ahmet Ajeti ka mbetur i plagosur.

Tentoi të vriste Lulzim Berishën, ekstradohet nga Kosova Ahmet Ajeti

U pagua 80 mijë euro bashkë me një person tjetër, ja si dështoi atentati i gushtit të 2005-ës

DËNIMI

Sipas burimeve policore, shtetasi Ahmet Ajeti ishte shpallur në kërkim ndërkombëtar nga Interpol Tirana më datë, 07.03.2016, pasi Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, Tiranë, me vendimin nr. 01 datë 16.01.2012, e ka dënuar me 20 vjet burg për veprat penale: "Vrasje me paramendim" dhe "Armëmbajtje pa leje".



Lulzim Berisha

Rezultojnë se ai ka qenë paksa më i veçuar nga dy të tjerët dhe se në një bar-bufte ka bërë një sherr banal, është grindur dhe në përpjekje për të nxjerrë armën e ka shkrepuar pa dashje atë, duke plagosur veten. Ai ka qëlluar edhe një herë në ajër. Në ndihmë të tij, kanë shkuar Osman Korpuzi e Sardinian Sulejmani, të cilët i kanë marrë pistoletën. Në vijim Sardinian Sulejmani i ka marrë Osman Korpuzit dy armë e zjarrit, pistoletë dhe është larguar, ndërsa i gjykuarit Osman Korpuzi ka njoftuar policët e qarkullimit rrugorë që po kalonin rastësisht në rrugë, me qëllim që t'i vinin në ndihmë shokut të tij

Ahmet Ajeti, që vazhonte të ishte i plagosur në hyrjen e një pallati.

Ahmet Ajeti është shoqëruar për në spitalin rajonal Durrës dhe nga pyetja e tij, si dhe e Osman Korpuzit, nga ana e policisë gjyqësore, e cila, fillim menjëherë veprimet hetimore për ngjarjen, prej këtyre shtetasve,

DOSJA

Provohet gjithashtu se të gjykuarve Osman Korpuzi e Ahmet Ajeti u është dhënë edhe një fotografi e të pandehurit Lulëzim Berishë. Në datën 30.08.2005, rreth mesditës, të gjykuarit Osman Korpuzi e Ahmet Ajeti, të armatosur janë nisur në drejtim të lokalit, ku qëndronte zakonisht i gjykuari Lulëzim Berishë, me qëllim vrasjen e tij. Së bashku me ta ka qenë edhe Sardinian Sulejmani, i cili kishte për detyrë të kujdesej për ta derisa të realizonin vrasjen e Lulëzim Berishës.

nuk është treguar qëllimi i vërtetë i ardhjen së tyre nga Kosova, duke u justifikuar me arsyen e pushimeve në plazhin e Durrësit. Ndaj këtyre shtetasve kosovarë është ushtruar kontroll fizik nga ana e policisë gjyqësore, prej nga ka rezultuar se në portofol i është gjendur një fotografi e të gjykuarit Lulëzim Berishë e mbështjellë, e cila së bashku me celularin i janë sekuestruar.



Aksioni antidrogë, përfundojnë në pranga 3 persona

TIRANË - Tre persona janë arrestuar nga policia në Tiranë në vijim të luftës kundër drogës. Në total janë sekuestruar 63.2 gr kanabis sativa. Nga Seksioni për Hetimin e Narkotikëve u bë arrestimi në flagrancë i shtetasve: Përpamir Sula, 50 vjeç dhe M.H., 17 vjeç, të dy banues në Tiranë, pasi në rrugën "Riza Cuka", në sheshpushimin e pallateve, gjatë kontrollit të ushtruar u kapën në flagrancë me 56.8 gr kanabi lëndë të dyshuar narkotike e llojit kanabis sativa. Gjithashtu, u kap dhe Hanson Merkohasana, 27 vjeç, banues në Tiranë, pasi tek "rreth-rrrotullimi i Saukut", gjatë kontrollit të ushtruar në mjetin e tij tip "Benz Mercedes", u gjet e bllokua 6.4 gr lëndë e dyshuar narkotike e llojit kanabis sativa. Materialet i referuan Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë në ngarkim të shtetasve të lartpërmendur për veprat penale "Prodhimi dhe shitja të lëndëve narkotike", parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal", thuhet në njoftimin zyrtar të policisë.

"Krimineli Safet Rustemi fshihet në Velipojë"

Deportimi i shqiptarit të shumëkërkuar përplas qeverinë dhe opozitën në Belgjikë



Safet Rustemi

BELGJIKË - Ministri i Emigracionit në Belgjikë, Theo Francken, i cili vizitoi Tiranën pak muaj më parë është vënë në shënjestër nga opozita belge për deportimin e Safet Rustemi alias Safet Bajri, shqiptari nga Shkodra, i konsideruar si një nga kriminelët më të kërkuar në Belgjikë. "Brusselstime" ashtu si edhe media të tjera belge e konsiderojnë atë si përfaqësues të një prej 5 familjeve mafioze që kontrollojnë bregdetin e Velipojës. Opozita belge kritikon ministrin, që duke qenë përkrahës i politikave të debilit të emigrantëve, ka deportuar Rustemin në Shqipëri, ku kontrollon rrjetin kriminal nga Shkodra. Megjithatë ishte në krye të listës së njerëzve të kërkuar nga drejtësi belge, Rustemi u deportua në Shqipëri, duke përfutur nga politikat e qeverisë për largimin e emigrantëve. Safet Rustemi ishte përfshirë në trafik droge dhe shfrytëzimin prostitucioni në lagjen 'Alhambra' të Brukselit dhe ishte dënuar me 22 vjet burg.

PËRPLASJA QEVERISË OPOZITË

Nga përshkrimi që i bëjnë policia në listën e të shumëkërkuarve, Rustemi ishte "ekstremisht i dhunshëm" në trafik qeniesh

njerëzore, tentativë vrasjeje, shkatërrim prone, armëmbajtje pa leje dhe grabitje.

Por në vend që ta mbanin në burg, ai u deportua me avion nga Zyra e Emigracionit drejt vendlindjes së tij në Shqipëri. "Ishte kjo zyrë që vendosi që Safet Rustemi nuk mund ta vuanë dhe nuk do ta vuanë dënimin", ka thënë avokati i tij, Sven Mary, për një të përditshme belge. Por mediat shkruajnë se shqiptari vazhdon t'i drejtojë bizneset e tij kriminale në Bruksel që nga Shqipëria. Ministri

për Emigracionin, Theo Francken e mbrojt vendimin: "Shqipëria nuk është fundi i botës", shkroi ai në "Twitter". Përfshirja e tij në listën e deportimit ishte sinjal për autoritetet shqiptare që ta arrestojnë këtë njeri. "Kemi një marrëveshje ekstradimi me Shqipërinë" shtoi ai. Por një deputet i opozitës belge, Uter de Vriend e akuzoi ministrin se ishte i obsesionuar pas deportimit të emigrantëve, edhe kur këta t'i shpëtojnë drejtësisë. "Ky lloj deportimi na sjell rreze të mëdha. Këta lloj kriminelësh janë të aftë ta na rrezikojnë edhe nga jashtë vendit. Obsesioni për t'i hequr qafe me nxitim është rrezik për sigurinë tonë", tha ai. Ministri Francken ka premtuar që do të hetojë më tej për atë që ka ndodhur. Çështja e deportimit të Safet Rustemi është thkyer në temë ditë për mediat belge që kanë shkruar më tej, duke raportuar për aktivitetin kriminal të tij në Shkodër: Më 18 korrik edhe "Le derniere heure" shkruante se kriminelin më i kërkuar në Belgjikë, Safet Rustemi, fshihet

TIRANË - Një muaj pasi kryetari i Gjykatës Kushtetuese, Bashkim Dedja u konfirmua në detyrë duke kaluar vettingun, ndërkombëtarët kanë apeluar vendimin. Mësohet se ONM kërkon apelimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për të. Në njoftimin për shtyp të Komisionerëve Publikë thuhet: "Në datë 13.07.2018, Komisioni i Pavarur të Kualifikimit u ka njoftuar Komisionerëve Publikë vendi-



Kaloi vettingun, ONM ankimon vendimin për kryetarin e Gjykatës Kushtetuese, Bashkim Dedja

min nr.24, 13.06.2018 në lidhje me konfirmimin në detyrë të z. Bashkim Dedja, kryetar i Gjykatës Kushtetuese. Në të njëjtën datë, 13.07.2018, Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit u ka paraqitur Komisionerëve Publikë rekomandimin për të ankimuar këtë vendim të Komisionit të

Pavarur të Kualifikimit në Kolegjin e Posaçëm të Apelit. Komisionerët Publikë janë duke shqyrtuar vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe rekomandimin e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit. Afati i fundit për të paraqitur ankim nga Komisionerët Publikë është

data 28.07.2018". Komisionerët Publikë janë duke shqyrtuar vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe rekomandimin e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit. Afati i fundit për të paraqitur ankim nga Komisionerët Publikë është data 28.07.2018. Ankimi i ven-

dimit lidhet me pasurinë e kreu të Kushtetueses, pasi dosja e tij përcau edhe trupën gjyqësive të KPK të përbërë nga Valbona Sanxhaktari, Roland Ilija dhe Xhensila Pine. Ndryshe nga Valbona Sanxhaktari dhe Roland Ilija, relatorja e çështjes, Xhensila Pine doli në konkluzionin se Bashkim Dedja duhej të shkarkohej nga detyra me pretendimin se nuk provon me dokumentacion një pjesë të pasurisë.

Kryegjyqtari: Kam 40 vite karrierë, nuk kam përfituar asnjë cent

Vetingu, KPK: Kreu i Gjykatës së Lartë, Xhezair Zaganjori ka shmangur taksat

"Ka të dhëna kontradiktore për pasurinë"

TIRANË

Kryetari i Gjykatës së Lartë, Xhezair Zaganjori është përballur dje me procesin e vettingut. Ai ka marrë pjesë në seancën dëgjimore të zhvilluar nga Komisioni i Pavarur të Kualifikimit që drejtohet nga Olsi Komici, me anëtarë Roland Ilija dhe Pamela Qirko. KPK, referuar raportit të ILDKPI bëri me dije se Zaganjori ka bërë deklaramin të saktë dhe ka burime të ligjshme pasurie. Por, nga ana tjetër, KPK ka konstatuar probleme me pasurinë e tij dhe ka fshehur taksat. Kryegjyqtari zotëron një pasuri familjare me vlerë rreth 58.7 milionë lekë, ndërkohë që të ardhurat ndër vite llogariten në 99.7 milionë lekë.

PASURIA

Sipas relators Pamela Qirko, kreu i Kushtetueses, Xhezair Zaganjori ka në pronësi një apartament 293 m² në bashkëpronësi në rrugën "Dedë Gjon Luli", me vlerë 5.8 milionë, që ka si burim shitjen e një apartamenti; një dyqan me vlerë 1.4 milionë lekë nga të ardhurat personale dhe të qirasë; zyrë me sipërfaqe 15 m²; apartament 81 m² në Lagjen 13, në plazhin e Durrësit, blerë në vitin 2006 për 32 mijë dollarë. Në përfundim të hetimeve, ka rezultuar se për apartamentin 293 m², Zaganjori ka deklaruar se e ka blerë nga të ardhurat e shitjes së një apartamenti tjetër. Por, nga ZRVP është konfirmuar se për këtë pasuri ekzistojnë të dhëna kontradiktore. Konkretisht ka thënë në kontratën e blerjes 500 mijë lekë, por në deklaratën e vettingut thotë se ka vlerë 5.8 milionë lekë. Për dyqanin me sipërfaqe 70 m² ka deklaruar se e ka blerë për 1.4 milionë lekë me të ardhura nga familja dhe qiratë. Në deklaratën fillestare ai e ka deklaruar si bibliotekë. Xhezair Zaganjori ka deklaruar bodrum 65 m² të blerë për 800 mijë lekë, me të ardhura familjare dhe qira. Sipas deklaramëve, rezultoi se vlera e kësaj pasurie është 500 mijë lekë, bazuar kjo në kontratën e shitjes. Asnjë nga këto pasuri nuk është në përputhje me njera-tjetrën, si me kontratën e shitblerjes. Për këtë pasuri është paguar sipas vlerës së kontratës dhe jo vlerës reale të pasurisë. Subjekti ka kryer deklaramin të pasaktë edhe për këtë pasuri dhe ka shmangie të detyri-



Kryetari i Gjykatës së Lartë, Xhezair

meve në buxhetin e shtetit, pasi nuk ka deklaruar vlerën reale të kësaj pasurie. Subjekti në deklaratën e vettingut ka deklaruar 15 m² katrorë si zyrë të blerë me vlerën 500 mijë lekë. Kjo pasuri është deklaruar nga Zaganjori edhe në vitin 2003, me të ardhura nga qiraja e bibliotekës. Nga hetimi është vërejtur se asnjë nga deklaratat për këtë pasuri nuk është në përputhje si për vlerën, ashtu edhe për sipërfaqen. Për këtë pasuri është paguar detyrimi tatimor sipas vlerës së kontratës dhe jo vlerës reale. Për shkollimin e djalit në Londër, Zaganjori ka deklaruar vetëm pagesën e shkollës gjatë periudhës 2008-2013. Diferenca mes asaj që ka deklaruar dhe shpenzimeve reale në Londër është 12 000 paund. Gruaja e Xhezair Zaganjorit ka qenë akcionere në një shoqëri që është mbyllur në vitin 2009, por Zaganjori nuk e ka deklaruar kurrsë këtë fakt. Për llogaritë bankare të bashkëshortes, në deklaratën periodike nuk janë deklaruar llogaritë e bashkëshortes prej 1.2 milionë lekë dhe 578 mijë lekë. Për llogarinë bankare të vitit 2007 nuk është deklaruar hapja e llogarisë rrjedhëse 747 284 lekë, kishte detyrim ta dek-

laronte. Në fund të vitit 2017, pasuria familjare e Xhezair Zaganjorit është rritur me katër herë, duke kapur vlerën e 58.7 milionë lekëve.

DEKLARATA E ZAGANJORIT

Kreu i Gjykatës së Lartë, Xhezair Zaganjori, pasi u

përball dje me KPK për t'iu nënshtruar kështu vettingut, ka dhënë një deklaratë për mediat. Zaganjori pohoi se ishte njeri i ligjit, ndaj edhe kishte shkuar dje në seancë, ndërsa shtoi se për 40 vite karrierë ka punuar me përkushtim. "Nuk është momenti për intervista. Jam njeri i ligjit dhe erdha në proces. E kam mbështetur reformën në drejtësi, ndaj kam respektuar KPK dhe kam dokumentuar gjithçka. Kam 40 vite punë dhe kam punuar me përkushtim. Kam kaluar dhjetëra e mijëra studentë e vendime dhe ndërgjegjeve e kam të pastër e dal para kujt, pasi s'kam përfituar asnjë cent nga dikush si pedagog, gjyqtar kushtetues, i lartë apo jurist", tha ai. Ndërkohë, vendimi për kryetarin e Gjykatës së Lartë pritet të merret më 24 korrik.

Shpërthim me eksploziv në dyqanin e motrës së gjyqtarit Fatos Lulo

TIRANË - Një shpërthim me eksploziv ka ndodhur në orët e para të mëngjesit të djeshëm, në dyqanin e Drita Lulos, motra e ish-gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, Fatos Lulo, që u shkarkua në fillim të procesit të vettingut. Mësohet se ngjarja u shënua rreth orës 02:10, në rrugën "Ymer Kurti", në Tiranë. Sipas policisë, shpërthimi ndodhi në katin e parë të një pallati, pranë qepenit të një dyqani bosh, në pronësi të shtetases D.L., ku për pasojë ka pasur vetëm dëme materiale. Konkretisht, nga shpërthimi i lëndës plasëse është dëmtuar qepenit i dyqanit, 3 mjete përballë tij dhe dera kryesore e pallatit. Burime për "GSH" pohuan se eksplozivi ishte mesazh për biznesmenen e njohur në Tiranë. Aktualisht Drita Lulo ndodhet jashtë vendit, ndërsa në komisarionin nr. 2 në kryeqytet kanë shkuar të afërm apo banorë të zonës për të sqaruar ngjarjen. Në katet më sipër ajo kryen edhe aktivitetin e një kompanie ndërtimi, ku zotëron 30% të aksioneve. Ndërkaq, policia po punon intensivisht për identifikimin dhe kapjen e autorit/ve dhe sqarimin e mëtejshëm të rrethanave të ngjarjes.

ILDKPI: S'justifikon pasurinë, s'ka burime të ligjshme

Prokurorja Rovena Gashi bojkoton vettingun: KPK e ka marrë vendimin para 8 muajsh



Prokurorja Rovena Gashi

subjekti i rivlerësimit, Rovena Gashi, kërkon rikonfirmimin në detyrë si prokurorë në Prokurorinë e Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë", - thuhet ndër

të tjera në shkresën e Rovena Gashit. Ndërkaq, Komisioni i Pavarur të Kualifikimit ka gjetur pasaktësi në justifikimin e pasurisë së Gashit. Relatori i seancës, Luzlim

Hamitaj, duke iu referuar raportit të ILDKPI thua se deklarimi i pasurive të Rovena Gashit nuk është i saktë, ka mungesë për të justifikuar pasuritë. KPK ka ngritur dyshime për 16 apartamente në Durrës, të cilat dyshohet se i përkaasin Nuredin Gashit, babait të Rovena Gashit, të paktën sipas faturave të OSHEE, ndërsa prokurorja pretendon se babai i saj është administrator i pallatit. Vendimi i Komisionit të Pavarur të kualifikimit për prokurorin Rovena Gashi pritet të jepet më 25 korrik.

Tokat e zëna nga ndërtime pa leje, pronarët marrin 70% të vlerës së pronës

Ornela Manjani

ATP, lista me pronarët që marrin 224 milionë lekë

Paratë kalojnë në llogari brenda pak ditësh

Agjencia e Trajtimit të Trajtimit të Pronave (ATP) njofton se më datë 20.07.2018 ka përfunduar procesin e shqyrtimit për 70 (shtatëdhjetë) kërkesa, të paraqitura nga subjektet përfituese, pronarë të pasurive të paluajtshme, pronë private, të prekura nga ndërtime informale, që përfitojnë deri më tani kompensimin/shpërbllimin në vlerë, në masën 70% të shumës së

përgjithshme në të holla, të miratuar me Vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave", - thuhet në njoftimin e ATP-së. Fondi financiar që shpërndahet nga Agjencia e Trajtimit të Pronave për 70 kërkesa është në vlerën 224 294 010 lekë. "Procesi i shqyrtimit të këtyre kërkesave dhe i shpërndarjes së fondit të kompensimit është

bazuar në ligjin nr.9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.383, datë 19.05.2010 "Për përcaktimin e procedurave të shpërndarjes së fondit të kompensimit në vlerë për pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga

ndërtime informale", i ndryshuar dhe në vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave, në të cilët është përcaktuar masa e shpërbllimit për secilin pronar. Për 70 kërkesat e mësipërme, për të cilat ka përfunduar procesi i shqyrtimit nga ana e ATP-së, ka rezultuar se dokumentacioni i tyre është në përputhje me kriteret e përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 383, datë 19.05.2010 "Për përcaktimin e procedurave të shpërndarjes së fondit të kompensimit në vlerë për pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtime informale", i ndryshuar", - thuhet në njoftim. Agjencia bën të ditur se 70 kërkesa përfi-

tojnë kështu edhe në ditët e tretë, të katërt dhe të pestë të kompensimit në të holla, në një total prej 70% të vlerës totale të miratuar me VKM-të përkatëse. Të dhënat në lidhje me pasuritë që kompensohen dhe mbi gjeneralitetet e subjekteve përfitues janë në listën që boton të plotë "Gazeta Shqiptare". "Agjencia e Trajtimit të Pronave (ATP) njofton subjektet e interesuara se vlerat përkatëse për secilin përfitues do të jenë disponibël në llogaritë e tyre në bankat e nivelit të dytë pas përfundimit të procedurave të transfertave bankare në ditët në vazhdim", - thuhet në njoftim.

PRONARËT QË MARRIN 224 MILIONË LEKË

1	464-A	13.03.2013	MERITA	HAMIT	KALLAJXHI	TIRANE	8250	5/233
2	843-A	28.07.2015	ANILA	NIKOLLAQ	SHAMETI	TIRANE	8270	6/378
3	843-B	03.08.2015	MIMOZA	NIKOLLAQ	SHUTURIQI	TIRANE	8270	6/378
4	864-A	18.08.2015	GEZIM	HYSEN	GRORI	TIRANE	8120	8/564
5	843-C	21.08.2015	FRIDA	SKENDER	JASA	TIRANE	8270	6/378
6	843-D	21.08.2015	ANI	HEKTOR	JASA	TIRANE	8270	6/378
7	843-E	09.09.2015	REZART	SKENDER	JASA	TIRANE	8270	6/378
8	843-F	10.09.2015	FITNET	XHEMAL	JASA	TIRANE	8270	6/378
9	843-G	11.09.2015	GENC	ESAT	JASA	TIRANE	8270	6/378
10	843-H	30.09.2015	GEZIM	SYRI	JASA	TIRANE	8270	6/378
11	843-I	01.10.2015	BESNIK	SKENDER	JASA	TIRANE	8270	6/378
12	478-E	16.10.2015	HAXHI	HAMDI	ALLA	TIRANE	2679	440/136
13	923-D	23.10.2015	ENGJELUSHE	TODI	DUIJA	ELBASAN	8526	117/1/9
14	923-B	23.10.2015	THOMA	SOKRAT	KELA	ELBASAN	8526	117/1/9
15	923-A	23.10.2015	GIJNOVEFA	NAUN	NIKOLLA	ELBASAN	8526	117/1/9
16	923-C	23.10.2015	PRANVERA	DHIMITER	NIKOLLA	ELBASAN	8526	117/1/9
17	843-J	26.10.2015	YLLI	NAIM	JASA	TIRANE	8270	6/378
18	843-K	06.04.2016	ERMIRA	SIRI	JASA	TIRANE	8270	6/378
19	1053-A	27.04.2016	LIRI	MEHMET	LEKA	TIRANE	8340	2/137
20	478-F	14.06.2016	FATBARDHA	HAMDI	MULLAHI	TIRANE	2679	440/136
21	1194-A	02.09.2016	SHPRESA	REXHEP	KERÇANI	TIRANE	8190	2/521
22	478-G	24.11.2016	MEREME	SHEFQET	BEZHANI	TIRANE	2679	440/136
23	948-L	18.01.2017	HYSEN	HAKI	LEKA	TIRANE	8330	5/70
24	1419-B	05.05.2017	ARBEN	SHEFQET	HOXHA	TIRANE	8370	3/731
25	1423-A	05.05.2017	ARBEN	SHEFQET	HOXHA	TIRANE	8370	3/802
26	1454-A	30.05.2017	MIMOZA	SHEFQET	ISAJ	TIRANE	8310	4/531
27	1454-B	31.05.2017	FITNET	XHELO	TAMBURI	TIRANE	8310	4/531
28	1454-C	01.06.2017	REBEKA	IRFAN	DOLLANI	TIRANE	8310	4/531
29	1454-D	01.06.2017	MANJOLA	SELIM	GJELI	TIRANE	8310	4/531
30	1454-E	05.06.2017	ELMA	BAJRAM	MATI	TIRANE	8310	4/531
31	1454-F	08.06.2017	BUKURIE	IRFAN	SHKUPI	TIRANE	8310	4/531
32	1454-G	08.06.2017	ARIJAN	QEMAL	GJELI	TIRANE	8310	4/531
33	1454-H	09.06.2017	MIRVJENA	SELIM	GJELI	TIRANE	8310	4/531
34	1482-A	13.06.2017	LIRI	MEHMET	LEKA	TIRANE	8340	5/34
35	1419-C	24.07.2017	ESAD	XHAVIT	MATJA	TIRANE	8170	3/731

36	1423-C	24.07.2017	ESAD	XHAVIT	MATJA	TIRANE	8170	3/802
37	1454-I	26.10.2017	VJOLLCA	SELAJDIR	HOXHALLARI	TIRANE	8310	4/531
38	1524-A	20.12.2017	ERNESTINA	VILI	SHTINO	ELBASAN	8523	9/39
39	1619-A	22.01.2018	ROLAND	SULEJMAN	QOSIA	TIRANE	8260	6/687
40	1635-A	22.01.2018	MHILL	NIK	RAMAJ	TIRANE	8190	8/447
41	1687-A	29.01.2018	ROLAND	SULEJMAN	QOSIA	TIRANE	8260	6/687
42	1688-A	29.01.2018	ROLAND	SULEJMAN	QOSIA	TIRANE	8260	6/703
43	1689-A	29.01.2018	ROLAND	SULEJMAN	QOSIA	TIRANE	8260	6/687
44	1690-A	29.01.2018	ROLAND	SULEJMAN	QOSIA	TIRANE	8260	6/687
45	1691-A	29.01.2018	ROLAND	SULEJMAN	QOSIA	TIRANE	8260	6/687
46	1790-A	02.03.2018	AISHE	HASAN	BELALLA	TIRANE	8170	3/304
47	1790-B	02.03.2018	MYZEJEN	HASAN	KAZAFERI	TIRANE	8170	3/304
48	1790-C	02.03.2018	YLLI	HASAN	NALLBANI	TIRANE	8170	3/304
49	1795-B	07.03.2018	ANI	ALBERT	DOMI	ELBASAN	8521	16/620
50	1795-A	12.03.2018	SYMIR	HAMIT	DEMIRI	ELBASAN	8521	16/620
51	1821-A	19.03.2018	BEQIR	MEHMET	DERHEMI	TIRANE	8340	2/201
52	1828-A	20.03.2018	ARBBI	DASHAMIR	AGALLIU	VLORE	8605	20/81
53	1849-A	27.03.2018	ROLAND	SULEJMAN	QOSIA	TIRANE	8260	6/677
54	1855-A	03.04.2018	SHPRESA	REXHEP	KERÇANI	TIRANE	8190	3/112
55	1155-F	05.04.2018	DILE	ZENEL	MURTHI	TIRANE	8340	2/199
56	1156-G	05.04.2018	DILE	ZENEL	MURTHI	TIRANE	8340	4/123
57	1158-F	05.04.2018	DILE	ZENEL	MURTHI	TIRANE	8340	4/123
58	1155-G	10.04.2018	IURIJANA	MALIQ	SPAHIU	TIRANE	8340	2/199
59	1158-G	10.04.2018	IURIJANA	MALIQ	SPAHIU	TIRANE	8340	4/123
60	1889-A	30.04.2018	VALDET	FADIL	ZHABJAKU	SHKODER	8594	9/180
61	669-H	21.05.2018	ASLLAN	DURGUT	SHARRA	TIRANE	8120	6/487
62	1714-E	24.05.2018	BLENDI	MUSA	BAKALLI	ELBASAN	8527	1372/7
63	989-K	06.06.2018	ILIR	QERIM	ALLUSHI	TIRANE	8310	5/115
64	1134-L	06.06.2018	ILIR	QERIM	ALLUSHI	TIRANE	8310	7/48
65	1134-M	06.06.2018	BUJAR	OSMAN	DEMNERI	TIRANE	8310	7/48
66	1142-H	11.06.2018	SADETE	BEDRI	ÇAUSHI	TIRANE	8230	5/405
67	1134-N	18.06.2018	DASHAMIR	ALI	TOSKA	TIRANE	8310	7/48
68	1134-O	20.06.2018	IBRAHIM	ALI	TOSKA	TIRANE	8310	7/48
69	989-M	21.06.2018	IBRAHIM	ALI	TOSKA	TIRANE	8310	5/115
70	2000-A	23.06.2018	ARBEN	BESIM	FAGU	TIRANE	8120	4/335

Dosjet e viteve 1993-2008, formulari-tip për informim në lidhje me ecurinë e vendimeve

Ornela Manjani

Pronarët në Korçë, ATP merr në shqyrtim 10 mijë dosje

Problematikat, procedurat për t'u njohur me ecurinë e shqyrtimit

Agjencia e Trajtimit të Pronave publikon listën me 10 mijë dosje ish-pronarësh, që janë në proces shqyrtimi nga kjo agjenci. Kërkesit janë në qarkun e Korçës. Në listën e përditësuar jepet numri i dosjes dhe data e aplikimit, gjeneralitetet e kërkesit, sipërfaqet e njohura për kompensim, dosjet për pronarët që kanë marrë vendim negativ dhe dosjet që duhet të plotësohen. Dosjet janë të viteve 1993 deri në vitin 2008. Agjencia e Trajtimit të Pronave ka vënë në dispozicionin të pronarëve formularin-tip, "Informacion në lidhje me ecurinë e dosjes", i cili duhet të plotësohet dhe të dorëzohet në 'Agjenci' për t'u njohur me fazën në të cilën ndodhet shqyrtimi i saj. Agjencia Trajtimit të Pronave është e detyruar që brenda 15 ditëve nga momenti i dorëzimit të kërkesës t'i kthejë përgjigje pronarit në lidhje me ecurinë e dosjes.

FORMULARI

Formulari i aplikimit për informacion në lidhje me ecurinë e dosjes është i ndarë në tri seksione. Aplikanti duhet të plotësojë gjen-

eralitet, adresën dhe të jetë i pajisur me mjet identifikimi në momentin e aplikimit. Në seksionin e dytë duhet të jetë përshkruar në mënyrë të saktë se në lidhje me çfarë kërkon informacion pala e interesuar, në këtë rast pronari që ka aplikuar për kthim e kompensim prone. Dhe në seksionin e fundit janë të specifikuar pesë dokumentet që duhet të disponojë pronari në momentin e aplikimit.

APLIKIMI

Për t'u njohur me ecurinë e dosjes, subjekti duhet të plotësojë dhe të paraqesë dorazi ose me postë pranë ATP-së kërkesën përkatëse me shkrim për informim në lidhje me ecurinë e dosjes, fotokopje të kartës së identitetit, dëshmi trashëgimie

DOKUMENTACIONI QË DUHET TE PARAQISNI

- Formulari-tip
- Fotokopje e kartës së identitetit
- Kopje vendimi nga ish-KKP/AKKP (nëse ka)
- Dokumente të tjera

dhe prokurë të posaçme. Në faqen zyrtare të ATP-së mësohet se subjekti plotëson kërkesën me shkrim për informim në lidhje me ecurinë e dosjes pranë Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun, në 'Agjenci'. Më pas, kërkesa i kalon zyrës së protokollit, e cila pasi e protokollon, ia dërgon të gjitha kërkesat e ardhura drejtorit të përgjithshëm. Kreu i AKKP-ës ia delegon kërkesat sek-

torit përkatës për ndjekje dhe zbatim. Më pas, sektori përkatës përgatit informacionin e kërkuar dhe njofton subjektin. Në përfundim të shqyrtimit, subjekti paraqitet pranë zyrave të ATP-së për të tërhequr shkresën e kthimit të përgjigjes në lidhje me ecurinë e dosjes ose i dërgohet me postë, sipas kërkesës. Aplikimi për kërkesën për informim mbi dosjen nuk ka kosto.

KORÇË

Nr./Dosj es	Rrethi	Emri (Subjekti kërkuës)	Atesia 2	Mbiemri (Subjekti kërkuës)	Sip. E Njohur/ Mosnjohje M2	Problematika
1133	Korçë	Spiraq		Çule	400	Me planvendosje te kesh te rrethit korçe
1134	Korçë	Adriatik		Vila	554	Pretendimi I bazuar vetem me VFJ
1135	Korçë	Mehmet		Ziso	324	Me planvendosje te kesh te rrethit korçe
1136	Korçë	Haxhi		Ziso	10234	Me planvendosje te komunes Pojan trajtuar truall sipas kufirit ligjor
1137	Korçë	Jetmir		Hunçi	2426	Me planvendosje te Keshillit te Rrethit Korçe trajtuar vetem truall
1138	Korçë	Jorgjia		Thimo	200	Me planvendosje te Keshillit te Rrethit Korçe
1139	Korçë	Islam		Merollari	4116	Trajtuar vetem toka truall
1140	Korçë	Nisret		Kadiu	1125	Pretendimi i nde baze VFJ
1141	Korçë	Muhamet		Xhuti	4205	Me planvendosje te komunes Pojan Trajtuar vetem me truall
1143	Korçë	Skender		Gongo	536	Me planvendosje te Keshillit te Rrethit Korçe
1144	Korçë	Uvi		Shanazo	1354	Trajtuar vetem toka truall
1145	Korçë	Sami		Bidollari	1600	Me planvendosje te Keshillit te Rrethit Korçe
1146	Korçë	Lavderim		Kulla	4700	Trajtuar vetem toka truall
1147	Korçë	Rafail	Uazo	Pengo	1420	Me planvendosje te Keshillit te Rrethit Korçe
1148	Korçë	Jani		Visari	2430	Me planvendosje te Keshillit te Rrethit Korçe
1150	Korçë	Julia		Tilka	1000	Me planvendosje te Keshillit te Rrethit Korçe
1226	Korçë	Gjergji		Bardhyli	1708	Gjykata ka ndryshuar vendimin nr.1025 vetem per sa i perketet formes se komp nga me obligacione ne nje nga format e percaktuara nga ligji
1263	Korçë	Xhevit		Buna	1000	Me planvendosje te Keshillit te Rrethit Korçe
1358	Korçë	Yllson		Kyçyku	3638	Me planvendosje te Keshillit te Rrethit Korçe
1091	Korçë	Ferit		Nake		Vertetim Kadastral. Harte e sek. Urb
1088	Korçë	Wiza		Suljoti	njohje totale	Vertetim Kadastral. Harte e sek. Urb
1085	Korçë	Spiro		Manushi	260	Vertetim Hipotekor; Harte e Sek. Urb
1083	Korçë	Andrea		Tira		VF. Harte e sek. Urb
1080	Korçë	Vasili		Morcka		Vertetim Kadastral. Harte e sek. Urb
1078	Korçë	Uazar		Morcka	1970	Vertetim Kadastral. Harte e sek. Urb
1079	Korçë	Olimbi		Lalo (Xhümetiku)	Njohje totale	Vertetim Hipotekor; Harte e Sek. Urb
1077	Korçë	Engjell		Orgucka	1679	VF. Harte e sek. Urb
1076	Korçë	Robert		Pejo		Vertetim Kadastral. Harte e sek. Urb
1110	Korçë	Lulezim		Sullollari	4496	Vertetim Kadastral. Harte e sek. Urb
1109	Korçë	Muhamet		Zhilla		Vertetim Kadastral. Harte e sek. Urb
1108	Korçë	Agron		Gjata		Vertetim Kadastral. Harte e sek. Urb
1101	Korçë	Resmije		Binjaku	1959	Vertetim Kadastral. F. Harte e sek. Urb

Nr./Dosj es	Rrethi	Emri (Subjekti kërkuës)	Atesia 2	Mbiemri (Subjekti kërkuës)	Sip. E Njohur/ Mosnjohje M2	Problematika
1099	Korçë	Haxhi		Demiri		Vertetim Kadastral. Harte e sek. Urb
1098	Korçë	Sotir		Robo		Vertetim Kadastral. Harte e sek. Urb
1096	Korçë	Ferit		Backa		Vertetim Hipotekor; Harte e Sek. Urb
	Korçë	Mitat		Backa	4400	Vertetim Hipotekor; Harte e Sek. Urb
1095	Korçë	Avdyll		Koçibelli		Vertetim Kadastral. Harte e sek. Urb
1093	Korçë	Zymbyle		Pelumbi	8880	Vertetim Kadastral. Harte e sek. Urb
1090	Korçë	Vasili		Jorgji	540	Vertetim Kadastral. Harte e sek. Urb
1107	Korçë	Liri		Sade		Vertetim Kadastral. Harte e sek. Urb
1100	Korçë	Avdulla		Lipi		F. Harte e sek urb
1097	Korçë	Hysni		Sefedin		Vertetim Kadastral. Harte e sek. Urb
1071	Korçë	Alio		Kabashi		Vertetim Kadastral. Harte e sek. Urb
1081	Korçë	Behije		Gura		Vertetim Kadastral. Harte e sek. Urb
1104	Korçë	Koço		Shule		Vertetim Kadastral. Harte e sek. Urb
1074	Korçë	Astrit		Lame		Ne dosje ndodhet vetem mandate pagesa per hapjen e dosjes
1075	Korçë	Koço		Ropi		Vertetim Kadastral. Harte e sek. Urb
1074	Korçë	Ramadan		Talka	3439	Vertetim Kadastral. Harte e sek. Urb
1072	Korçë	Qirjako		Minka	2500	Vertetim Kadastral. Harte e sek. Urb
1087	Korçë	Drita		Katrosi		Vertetim Kadastral. Harte e sek. Urb
1082	Korçë	Bajram		Pane		F. Harte e sek urb
1105	Korçë	Hekuran		Shemshedini	6366	Vertetim Kadastral. Harte e sek. Urb
1162	Korçë	Ali		Qiraxhi	9996	Ka p.vendosje me gjykate+ kadastr
1163	Korçë	Vangjush		Cavali	1300	Me kadastr ka p.vendosje
1173	Korçë	Janulla		Gjata	332	Me kadastr ka p.vendosje; Eshte trajtuar sip brenda vijave se verdte
1154	Korçë	Adem		Imami	900	Me kadastr ka p.vendosje
1171	Korçë	Vaske		Kolaci	9630	Me hipotek sip 2786 eshte fushe sporti
1176	Korçë	Jorgjia		Pano	700	Me kadastr ka p.vendosje
1180	Korçë	Fillor		Polena	1300	Me kadastr ka p.vendosje trajtuar vetem sip truall
1189	Korçë	Kostandina		Robo	100	Me kadastr ka p.vendosje trajtuar vetem sip truall
1178	Korçë	Thomaz		Terazi	1000	Me kadastr ka p.vendosje
1151	Korçë	Jorgjia		Me lo	800	Me kadastr ka planvendosje
1155	Korçë	Mentor		Doko	10234	Me kadastr ka planvendosje
1159	Korçë	Natasha		Cepa	200	Me kadastr ka planvendosje
1164	Korçë	Muhamer		Sullollari	3000	Me kadastr ka planvendosje
1167	Korçë	Xhezmi		Bardhollari	2614	Me kadastr ka planvendosje. Trajtuar sip brenda vijave te kufizuar te fshtatit
1184	Korçë	Selajdin		Mydinllari	1500	Me kadastr ka planvendosje
1183	Korçë	Vangjeli		Bendo	1080	Me kadastr ka planvendosje



BLUE TOOTH

Thashetheme
MADE IN ALBANIA

Nr. 619

SUPLEMENT I PERJAVSHEM GAZETA SHQIPTARE

Art Designer: Nevila Samarxhi

E shtunë 21 Korrik 2018

RIKTHIM NE ÇIFT? Ledri Vula darkon me të atin e Dua Lipës



KEJDA AJAZI Vajza e Majlinda Bregut, super yll...



KRISTINA BAKI:

Shifra më
tërheqëse që
më kanë ofruar
për punë...

*"E shoh shumë larg fejesën
apo martesën, momentalisht
fokusi është te vetja"*



Modelja shqiptare vjen në një rrëfim ndryshe për pasionet, jetën dhe punën

KRISTINA BAKI:

Shifra më tërheqëse që më kanë ofruar për punë...



“E shoh shumë larg fejesën apo martesën, momentalisht fokusi është te vetja”

Ajo është një nga vajzat më të bukura të Shqipërisë, titull i cili u vendos në vitin 2013 ku u kurorëzua si ‘Miss Universe Albania’. Vajzë e thjeshtë dhe e dashur që gjithmonë është përpjekur të besojë e të japë besim por nuk ka marrë pas atë që ka dhënë. Kristina Baki përfaqësuesja e Shqipërisë në ‘Miss World 2015’ në ishujt Hainan të Kinës tregon pasionet dhe heqjen dorë nga disa ëndrra të ndryshuara gjatë rrugës...

Kaloi edhe një sezon i ngjeshur me projekte dhe

angazhime. Cili është hapi i radhës për Kristinën në shtator?

Planet për në shtator sigurisht që janë të shumta, por dëshira ime vazhdon të ngelet udhëtimi jashtë dhe kontratat me agjenci të ndryshme. Vëdin se ku s’e kam vendosur akoma, por kjo mbetet për t’u parë në vazhdim.

A do të keni ndonjë ndryshim në horizont lidhur me punën?

Sic e thashë edhe në përgjigjen më sipër, do vazhdoj të qëndroj te modelingu,



Era Istrefi dekorohet me medalje presidenciale nga Hashim Thaçi

Ajo ishte zëri zyrtar i Botërorit "Rusi 2018", ku fituese u shpall Franca, ndërsa emri i saj dhe Kosovës nga vjen, ngrihet çdo ditë me prestigj në botë. Pikërisht për këtë arsye, Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi e dekoroi zërin e artë me medaljen presidenciale. Ata biseduan për sukseset e njëpasnjëshme të Erës dhe së fundmi për arritjen e saj në Kampionatin Botëror "Russia 2018". Pas takimit, Era Istrefi ka publikuar disa momente me Presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi duke e falënderuar atë. "Ne ndërruam dhuratat me Presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi. Ai më dha mua medaljen e artë, ndërsa unë i dhashë topin e Kupës së Botës të shënuar nga unë, Will Smith, Nicky. Jam shumë falënderuse për përkrahjen e Kosovës, vendit tek i cili jam lindë e rrit", shkruan këngëtarja.



Klea Huta lë SHBA-të dhe nisjet me urgjencë për në Tiranë... arsyeja

Me siguri e keni mësuar se sheshi "Skënderbej", më 25 korrik, do të ushtojë nga muzika më e mirë e artistëve shqiptarë si Ylli Limani, Dhurata Dora, Arilena Ara, Eugent Bushpepa, Young Zerka... Gjithashtu, keni mësuar se e ftuara speciale do të jetë këngëtarja me origjinë shqiptare, Eleni Foureira. I gjithë eventi muzikor vitin e kaluar u prezantua nga Klea Huta, por këtë vit, nga sa është mësuar, moderatorja dhe këngëtarja prej ditësh është në Amerikë për xhirimet e programit të ri që do të nisë sezonin e ardhshëm në "Top Channel". Siç shkruan "Blitz", Klea dhe grupi i saj i punës ka realizuar xhirimet e intervistës së Emina Çunmulajt dhe mbulimin e dasmës së Afërdita Dreshajt. Por, me sa duket, Klea i ka lënë në mes xhirimet dhe ka marrë fluturimin e parë drejt Tiranës për të prezantuar një prej koncerteve më të mëdha që do të mbahet në sheshin "Skënderbej".



udhëtimet dhe eksperiencat jashtë vendit.

Ku keni zgjedhur t'i kaloni pushimet këtë verë? Destinacioni i preferuar?

Momentalisht jam me pushime, ndodhem në Sarandë. Por, gjithsesi edhe një pushim tjetër nga gushti do ta doja. Por nuk është se jam njeri që bëj plane afatgjata. Nëse dua të bëj diçka, e vendos në moment ose maksimumi 2 ditë para,

kështu që edhe vendin se ku do shkoj me pushime s'e kam vendosur akoma. Por besoj se do të zgjedh ndonjë ishull grek.

Cila është gjëja që e identifikon Kristinën?

E qetë dhe e matur, të paktën këtë ma thonë shpesh dhe njerëzit që më rrethojnë.

A jeni e dashuruar? A keni plan për ndonjë ndryshim se shpejti?

E shoh shumë larg fejesën apo martesën, momentalisht fokusi është te vetja dhe puna ime.

Nga "Miss Shqipëria", në modele ndërkombe-tare. Cili është profesioni që gjithnjë e keni imagjinuar veten ta bëni, por s'keni mundur? A e keni në plan për ta realizuar?

Me ka pëlqyer shumë diplomacia, gjithmonë kam

dashur të bëhesha diplomate, për këtë arsye zgjedha të studioj për shkencat politike. Por, nuk mendoj se do e ushtroj ndonjëherë si profesion, sepse tani jam komplet në një drejtim tjetër.

Pika e dobët e Kristinës në karakter është...?

Besoj shumë tek njerëzit. Nuk është keq të besosh, por jo tek të gjithë.

A ju kanë propozuar ndonjë ofertë marrar-

mendëse ndonjë nga shtëpitë e njohura të modës?

Jo, nuk është se kam pasur ndonjë ofertë marramendëse nga ndonjë shtëpi e madhe mode, por gjithsesi deri tani më mjafton çfarë kam arritur, jam e kënaqur.


Sa ka qenë shifra më tërheqëse që ju është ofruar?

Shifra më tërheqëse ka qenë 5000\$ për reklamë.

Nënat e reja rikthehen fuqishëm me bikini, ja kush janë...



Perioda e paslindjes thuhet se është mjaft delikate për nënat e reja, të cilat duhet të kujdesen për shëndetin e tyre dhe të foshnjës së sapolindur. Kanë kaluar disa muaj që nga dita kur disa nga vajzat e ekranit shqiptar kanë sjellë në jetë vogëlushët e tyre, duke ju gëzuar ndjesisë të të qenurit nënë. Ky fakt nuk i ka penguar ato që pak kohë më vonë të ekspozohen në plazh me bikini, madje të ndihen edhe mjaft krenare për format e tyre fizike. Vajzat janë shfaqur në plazh duke dhënë shembullin e mirë, se shtatzënia është një proces natyral për gruan dhe shenjat që ajo lë në trupin e saj gjithashtu janë tërësisht normale. Më poshtë po sjellim një listë me nënat VIP, që po shijojnë rrezet e diellit, të cilat gjithashtu janë shumë të nevojshme për të vegjlit e tyre.



Gjithçka i përket së shkuarës, Ledri Vula darkon me prindërit e Dua Lipës



Kur këngëtarja me origjinë shqiptare Dua Lipa nuk kishte kende famën që ka sot, ajo dhe Ledri Vula thuhet se kanë qenë në një lidhje dashurie. Por gjithçka i përket të shkuarës, pasi dyshja ruajnë një marrëdhënie të mirë miqësie jo vetëm me njëri-tjetrin, por edhe me familjet respektive. Ledri ka raport shumë të mirë edhe me prindërit e Duas dhe këtë gjë e ka vërtetuar mbrëmjen e djeshme. Nga fotot dhe videot e postuara në rrjetet sociale shihet se Ledri së bashku me menaxherin e tij, Faton Shoshi kanë darkuar me prindërit e këngëtares, darkë e cila ka zgajtur deri në orët e para të mëngjesit. Të gjithë bashkë janë argëtuar dhe kanë kaluar disa momente të këndshme nën shoqërinë e njëri-tjetrit. A është kjo një shenjë për një bashkëpunim të mundshëm midis dyshes? Kjo ngelet për t'u parë në të ardhmen, ndërsa në gusht Ledri Vula dhe disa repera nga Kosova si Mc Kresha, Lyrical Son etj., do të performojnë në festivalin "Sunny Hill", i cili organizohet nga Dukagjin Lipa, por që do të sjellë në Kosovë edhe vetë vajzën e tij, Dua Lipa, e cila momentalisht po përjeton një sukses të jashtëzakonshëm në "showbiz"-in botëror, raporton "revistawho.com".



Nik Xhelili "terrorist", roli më i ri për shqiptarin

Tashmë të gjithë e dimë se aktori i njohur shqiptar, Nik Xhelilaj, ka filluar karrierën e tij në Turqi. Së fundmi, ai ka marrë një ofertë nga producentët turq, për t'u bërë pjesë e një seriali të ri. Nik Xhelilaj do të luajë në rolin e një shqiptari. Në intervistën e tij për "Nin", ai ka thënë: "Karakteri që do të luaj atje është shqiptar me origjinë nga Prizreni. Zgjedha të jetë nga Prizreni dhe tematika e filmit ka të bëjë me Sirinë. Do e nis me rolin e terroristit, por në seriale turke nuk dihet se si përfundon". Rikujtojmë se Xhelilaj ka qenë pjesë e serialeve të ndryshëm pranë aktorëve të njohur turq.



Klaudia Pepa hot në plazh, shiheni si ngjan

Me një copë shalqi në dorë dhe rroba banje rozë, balerina e famshme shqiptare pozon para objektivit, duke marrë një pozicion shumë sensual. Balerina ka zgjedhur brigjet e Italisë për të pushuar pas një sezoni të ngjeshur me punë. Klaudias i ka rënë një nur këto kohët e fundit dhe pas ndarjes me koreografin Albi Nako, duket se është rikthyer në formën e vet më të mirë shpirtërore, edhe pse çifti vazhdon mban lidhje miqësore.

Çmendet modelja serbe, "selfie" me babanë e vdekur

Një modele nga Serbia ka irrituar rrjetet sociale, duke postuar një "selfie" me trupin e babait të saj të vdekur në një spital, pas krahëve të saj. Jelica Ljubicic bëri një foto selfie, ndërkohë që i ati ishte shtrirë i pa jetë prapa saj, në shtratin e spitalit. Mediat lokale në Serbi raportojnë se burri ka vdekur pak çaste para se të bëhej fotoja. Me kokën e tij të varur mënjanë, Jelica është quajtur "e



sëmurë" për postimin e asaj fotoje. "Baba, prehu në paqe. Ne kemi luftuar aq sa mundëm, por nuk është në dorën tonë, - shkruajti modelja. - Ne nuk e vendosim dot sa gjatë të jetojmë. Ai na la në moshën 67-vjeçare. Faleminderit për gjithçka! Jam mirënjohëse që jam bija jote dhe që të kisha ty si baba". Jelica, e cila e përshkruan veten si këngëtare dhe modele, u detyrua të hiqte fotën, pas komenteve dhe kritikave të menjëhershme. Dikush shkruante: "Vetëm një person i sëmurë mund ta bëjë një gjë të tillë". Ndërsa, dikush tjetër shkroi: "Nuk mund ta besoj se çfarë po shoh e çfarë po lexoj. Jo, nuk ka shpresa për këtë botë".



Po afron dasma e shumëpërfolur, njerëzit në silket për veshjen

Ledion Liço dhe Sara Hoxha do të realizojnë në muajin gusht ceremoninë e tyre martesore, rreth një vit pas lindjes së djalit. Dasma do të mbahet në Villa d'Este në Komo të Italisë, ku qëndrimi për një person në këtë vilë kushton 500 euro dhe të ftuarit do të qëndrojnë në ambientin luksoz për 3 ditë. Megjithatë, të ftuarit ka disa javë që janë nën ankthin e performancës. Burime thonë për "Bluetooth" se një pjesë e tyre janë në kërkim të një veshjeje që duhet patjetër të bjerë ndër sy. Ndërkaq, pjesa tjetër e stafit realizues të dasmës janë më të qetë nga kjo anë, sepse veshjet e tyre i ka marrë përsipër çifti. Gjithsesi, pak ditë para dasmës Ledioni ka vendosur të heqë dorë nga rrjetet sociale duke mbyllur kështu "Instagram"-in e tij. Mund të jetë ky një veprim për të qenë tërësisht privat në këtë moment të rëndësishëm të jetës.

Vajza e Majlinda Bregut, super yll...

Vajza e ish-deputetes Majlinda Bregu shpesh është përfolur në rrjetet sociale për shkak të pamjes së saj super sensuale si dhe pozave provokuese që realizon. Kejda gjithashtu është një nga vajzat me një numër të konsiderueshëm ndjekësish në "Instagram". Ajo ka befusuar me fotot e saj të fundit, ku pozon super seksi. Edhe ajo është prekur nga tendencat më të fundit që përcjellin motrat Kardashian. Këto "Bike Short" nxjerrin në pah më të mirën e Kejdës raporton "Express".



Nuk ka dasmë edhe këtë vit mes Enit e Gencit...

Lajmi se këngëtarja Eni Koçi do të shkojë në altar me producentin e famshëm, Genc Prelvukaj, duket se do të presë edhe pak muaj, pasi burime nga këngëtarja kanë konfirmuar për "Blitz.al" se këtë vit nuk do të ketë dasmë. Çifti nuk e ka pranuar ende lidhjen e fortë që ekziston mes tyre, megjithatë nga mediat rozë nuk mundën të shpëtonin. Të njëjtat burime kanë treguar për "Blitz.al" se Eni dhe Genci aktualisht janë bashkë në koncerte të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, kudo ku ka shqiptarë.



Luizit i ka mbetur mendja te vajza e Jozefinës?

Vitin e kaluar këngëtari i njohur Luiz Ejlli dhe vajza e Jozefina Topallit, Megi i kanë dhënë fund lidhjes së tyre disavjeçare. Edhe pasi pranoi ndarjen, këngëtari ka vendosur të mos flasë për jetën private, madje as nuk ka dhënë arsye për ndarjen e tyre. Por një postim në rrjetet sociale të Luiz Ejllit ka tërhequr vëmendjen e të gjithëve. "Të gjes një femër të sinqertë sot është njëlloj sikur të gjes wifi në Gjirokastër pa password", - ka shkruar ai. Mund të mendojmë se ky është një mesazh i koduar, por kjo sërish mbetet për t'u parë...



Afërdita Dreshaj, kjo 'Hirushe' e ditëve të sotshme...

Sikur mos të mjaftonin të gjitha fotot, videot, surprizat e dasmës (dhe pas dasmës) së Afërdita Dreshajt, një javë përrallash në ishull për muaj mjaliti, bashkëshorti i saj, Jakub ende nuk është lodhur së surprizuar vajzën e tij të zemrës këtë verë. Më 19 korrik Afërdita ka festuar ditëlindjen e saj, ndaj dhe Jakub ka menduar 24 orë surprizë për të. Gjithçka ka filluar me një tufë lule, një çantë "Gucci" të koleksionit të fundit dhe një kartolinë shpjeguese se e gjithë dita do t'i shkonte me surpriza. Pa dijeninë e Afërditës, Jakub kishte prenotuar një jaht luksoz ku ata kaluan gjithë paraditen. Në vaktin e drekës, parkuan diku jahtin dhe u ulën për një drekë të këndshme buzë një pamjeje mahnitëse. Me t'u kthyer në jaht, e kur Afërdita kujtoi se gjithçka mbaroi, Jakub e surprizoi me një natë romantike në një restorant mjaft klas, ku kjo e fundit fryu edhe qirinjtë e ditëlindjes. Itinerarin e ka shpërndarë vetë Afërdita në "Instagram", duke na bërë të gjithave të xhelozojmë. Ju meshkujt e tjerë, a do merrni pak shembull?



Këngëtarja e njohur përfundon në spital psikiatrik, vuan nga depresioni

Shëndeti mendor vazhdon të jetë dita-ditës një nga problemet më shqetësuese për shumicën nga ne. Ashtu si të tjerat, sëmundjet mendore nuk zgjedhin as gjini, as moshë, as pasuri, as status e as profesion. Së fundmi, këngëtarja e njohur amerikane, Michelle Williams, ish-pjesëtarja e "Destiny's Child" ka treguar se prej kohësh vuan nga depresioni. Në një postim në "Instagram" dhe në rrjetet e tjera sociale, Michelle ka treguar se për shkak të depresionit i është dashur të shkojë në një spital psikiatrik. "Prej vitesh i jam dedikuar e gjitha punës dhe organizatave për rritjen e kujdesit ndaj shëndetit mendor dhe për t'u dhënë të tjerëve shpresë për të kërkuar ndihmë dhe mbështetje për mirëqenien e tyre - shkruan Michelle. - Së fundmi kam marrë parasysh të njëjtat këshilla që u kam dhënë qindra personave në të gjithë globin dhe kam kërkuar ndihmë nga një skuadër e tëra me profesionistë të shëndetit mendor". Ndërkohë, mediat e huaja kanë raportuar se prej ditësh Michelle gjendet në një spital psikiatrik, ku po merr ndihmën e duhur dhe të nevojshme për depresionin.

DEBATI

Artistët: Vlahutin na siguroi se po monitorohet rasti i Teatrit

Fatmira Nikolli

Të vendosur t'i shkojnë kauzës së mbrojtjes së te atrove kombëtare deri në fund, një grup artistësh prej 40 ditësh kanë lënë çdo angazhim për t'iu kushtuar qëllimit primar. Për shumikënd ngajnë si donkishotë që luftojnë me mullinjte e erës, por duket se udhëtimi ka për të qenë i gjatë dhe ata janë të vendosur. Një prej stacioneve të tyre ishte takimi i djeshëm me ambasadorën e Bashkimit Europian në Tiranë, Romana Vlahutin. Përgjatë dy orëve ata ndanë me shqetësimet që kanë mbi ligjin dhe procedurën që i hap rrugë shembjes së teatrove për të ndërtuar një të ri me PPP. Duke shpresuar që ligji i miratuar me 5 korrik nuk do të dekretohet nga presidenti i vendit, Ilir Meta dhe se ai do të ketë një qëndrim të paanshëm sikundër premtoi, artistët derisa në Shqipëri të nisë të rifunksionojë Gjykata Kushtetuese, shprehen se do ta "ruajnë" teatrin ditë e natë. Pas takimit me Vlahutin, aktori Alert Çeloalija tha para mediave çfarë biseduan. "Ne patëm mundësinë, që të shprehim të gjitha shqetësimet tona lidhur me çështjen shumë të rëndësishme për Teatrin Kombëtar. Folëm për rëndësinë e trashëgimisë edhe për çështjen e drejtës publike, për sipërfaqen publike. Bëmë të qartë se jemi kundër tjetërimit të kësaj prone dhe parashtruar mundësisë për të pasur të rikonstruktuar këtë godinë", tha ai. Mandej, regjisori Robert Budina pas takimit tha se bënë një pasqyrë të gjerë të asaj që ka ndodhur, një historik të kryeministrit shqiptar me godinën edhe me artistët në përgjithësi, i cili prej 18 vitesh ka dashur që ta marrë atë. "Ka 20 vite që thuhet se ky teatër duhet shembur. Interesi personal ka orientuar një shtet të tërë me ligje për ta sjellë tek vetja. Në momentin që duam që të futemi në Evropë nuk mund të futemi duke shembur TK. Kam përshtypjen se u perceptuam qartë. Dhamë edhe argumente ligjore që ata të dinë sesi po veprohet në Shqipëri. Ne nuk do të lejojmë që TK të shembet pa u bërë Gjykata Kushtetuese, prandaj nxisim edhe presidentin e vendit, që mos ta dekretojë këtë ligj", tha Robert Budina. Ai theksoi qëndrimin në vazhdim të artistëve kur tha se do ta ruajnë godinën nga ndonjë sulm i papritur, duke ndenjur aty. "Nuk mundet që ta shembin as natën dhe as ditën", u shpreh Budina në përgjigje të interesit të gazetarëve. Aktori Neritan Liçaj tha para mediave se zonja Vlahutin i ka siguruar personalisht se "po e monitorojmë të gjithë rastin. Ata dinë të bëjnë shumë mirë detyrën e tyre. Ne parashtruar problemet që ligji i aprovuar në 5 korrik bie në



MAKS VELO

Kishte një gjë me rëndësi Basha sot që paralajmëronte Fushën se ato pallate do hidhen në erë në baza të ligjit anti-mafia. Kjo ishte gjëja më me rëndësi. Se pallatet janë të paligjshme dhe nëse hedhin këtë në erë (drejtohet nga Teatri) dhe pallatet do hidhen në erë.

"Do ta ruajmë godinën ditë e natë nga ndonjë sulm i papritur"

kundërshtim me marrëveshjen e MSA-së. Ata duhet që të bëjnë raportin". Sipas Liçajt ky rast ka gjithë vëmendjen e ambasadores Vlahutin. Nga ana tjetër, ai tha se aktorët do të vazhdojnë hapat e rez-

istencës hap pas hapi dhe se janë në pritje të presidentit. "E kemi ushtruar edhe kemi bërë publike. Jemi në pritje të tij", shtoi ai. Shkrimtari Rudi Erebara tha pasditë se

TEATRI/ AUREL PLASARI: EPSHI PËR PUSHTET

Aurel Plasari ka mbështetur edhe dje protestën për teatrin përmes postimit të mëposhtëm në facebook: Artistët e teatrit mund të mos jenë mendimtarë, mund të mos jenë filozofë, por ata dinë Shekspirin, madje Shekspirin e Nolit tonë. Dhe kjo mjafton. Njëra nga parullat e tyre shekspiriane, "Teatri është gracka...", e ka thënë gjithçka. Dhe Shekspirin, miq, nuk i iket dot. Kam qenë 20 e ca vjeç kur, në përmbledhjen e Ve-

prave të Shekspirin, kam pas shkruar parathëniet për komeditë e tij "Komedia e keqkuptimeve", "Ëndrra e një nate vere" etj. Tani, në tjetër moshë, ia kuptoj më mirë tragjeditë, duke e dalluar qartë se përse ai i tmerroi tiranët me teatrin brenda teatrit dhe me formulën denoncuese "The lust for power". E kuptoj edhe se përse ish-diktatori, pikërisht në atë teatër që mbrohet sot, u ngrit nga kryelozha, në mesin e një tragjedie të Shekspirin, dhe iku. Mirëpo ai iket dot Shekspirin? Me ndjesë për pam-



undësi pjesëmarrjeje aty, për qëndresën e artistëve - përshirë edhe time mbesë - from Shakespeare with love.



BLUE TOOTH

THASHETHEME MADE IN ALBANIA



te rejat nga jeta ipave

con të shtunë falas me

Opinion i Ditës

Ndarja e Kosovës dhe një diplomaci në kaos

Nga Berat Buzhala

(vijon nga faqja 1)

...amerikan. Asnjë ambasador amerikan në botë, e as Greg Delawie, tash nuk e kanë as idenë më të vogël se çfarë qëndrimi politik ka shefi i tyre suprem.

Disa javë përpara se të mbareshin zgjedhjet në SHBA, një grup prej 75 ish-zyrtarësh të lartë të Departamentit të Shtetit, përfshirë ambasadorë, sekretarë dhe nënsekretarë shteti, e kishin nënshkruar një letër të hapur në të cilën ata tregonin arsyet përse nuk do të duhej të votohej Donald Trump, por Hillary Clinton.

Sipas tyre, Donald Trump ishte krejtësisht i pakualifikuar për të qenë President dhe Komandant Suprem i SHBA-ve.

"Ai është injorant për t'u përballur me natyrën komplekse të problemeve me të cilat përballlet shteti ynë, duke filluar nga Rusia, Kina, ISIS. Ai gjithashtu nuk ka shprehur interesim as për të mësuar diçka", thuhet në mes tjerash në letrën e ish-diplomatëve të shquar amerikanë, të cilët ishin edhe demokratë, edhe republikanë.

Në mesin e tyre ishin edhe disa diplomatë me renome, si bie fjala Morton Abramowitz, Nicholas Burns, Thomas Pickering. Të gjithë ata i kishin shërbyer SHBA-ve në plot 52 shtete, nga Rusia, në Mal të Zi, Ukrainë, Afganistan, Mozambik dhe shumë shtete të tjera.

Kjo ka qenë hera e parë që në mënyrë kaq masovike ish-diplomatët marrin anë në një palë zgjedhje. Dhe këta nuk ishin të vetmit. Këta ishin reflektim i disponimit të mijëra diplomatëve amerikanë, qoftë të atyre që janë në Uashington, ose atyre që janë të shpërndarë nëpër botë, për Donald Trumpin President të SHBA-ve.

Duke e marrë parasysh këtë, duke e marrë parasysh zotimin e tij që do të luftojë kundër establishmentit, nuk ishte ndonjë befasi e madhe kur Trump vendosi që t'u hakmerret diplomatëve të karrierës, sapo ai shkeli në Shtëpinë e Bardhë.

Trump, për ta dobësuar Departamentin e Shtetit, vonohej qëllimisht për t'i bërë emërimet e duhura në këtë sektor, si bie fjala zëvendëssekretarët. Sekretarin e tij të Parë të Shtetit, Rex Tillerson, e kishte lënë pa ndihmë dhe pa zëvendës për muaj të tërë. Në mënyrë të ngjashme kishte vonuar emërimet nëpër ambasada të fuqishme të Amerikës, posaçërisht në Lindje të Mesme.

Këtë boshllëk Trump e ka mbushur gjatë gjithë kësaj kohe duke i dhënë më tepër kompetenca dhëndrit të tij të papërvonit, e deri vonë edhe këshilltarit polari-



zues Steve Bannon, ose edhe vajzës Ivanka. Me muaj të tërë, ndoshta edhe më tutje, askush në Departamentin Amerikan të Shtetit nuk e di se cili është plani për zgjidhjen e konfliktit në mes të Izraelit dhe Palestinës. Këtë e di vetëm dhëndri Jared dhe vajza Ivanka. Madje, Trump nuk ndiente kurrfarë nevojë që të caktonte ambasadorë as në Egjipt e as në Arabi Saudite.

Të gjitha betejave ndërkomëtare Donald Trump i rrekej ose nisur prej instinktit të tij, ose në bazë të njohurive të tij mediokre në politikën e jashtme.

Kjo gjë më së miri është shprehur gjatë turneut të tij skandaloz në Evropë, që kulmoi me samitin po aq skandaloz dhe turpërues në Helsinik, me Presidentin rus, Vladimir Putin.

Gjatë qëndrimit të tij në Bruksel dhe Londër, Trump kur po i

numëronte armiqtë kryesor të SHBA-ve, së pari kishte përmendur BE-në, me theks të veçantë Gjermaninë, aleat besnik i SHBA-ve në këto 70 vitet e fundit. Po kaq turbullues ishte edhe gjatë qëndrimit në Britani të Madhe. Në mbrëmje fliste për "The Sun", duke e sulmuar ashpër kryeministren Theresa May, kurse të nesërmen thoshte se i janë falsifikuar fjalët.

Gjatë gjithë kësaj kohe ai bënte çfarë bënte, por kujdesej që ta trajtonte me mirësjellje dhe delikatesë vetëm një njeri: Presidentin rus, Vladimir Putin, për dëshirën e të cilit e godiste NATO-n, duke e quajtur si organizatë të vjetër dhe të dalë afatit. E kur jo nuk lu duk mjaft, Presidenti Trump vendosi, në një intervistë televizive, që ta hidhte nën autobus Malin e Zi, shtet ky anëtar i NATO-s. Tha se nuk e kishte të

Gjatë qëndrimit të tij në Bruksel dhe Londër, Trump kur po i numëronte armiqtë kryesor të SHBA-ve, së pari kishte përmendur BE-në, me theks të veçantë Gjermaninë, aleat besnik i SHBA-ve në këto 70 vitet e fundit. Po kaq turbullues ishte edhe gjatë qëndrimit në Britani të Madhe.

qartë përse një ushtar amerikan do të duhej të vdiste nëse Mal i Zi futej në një konflikt me një vend joanëtar të NATO-s.

Është e paimagjinueshme se si duhet të këtë reaguar ambasadori i SHBA-ve në Mal të Zi, kur e ka dëgjuar këtë deklaratë të shefit të tij suprem. Janë thjesht të paimagjinueshme edhe reagimet e ambasadorëve të tjerë të SHBA-ve, kudo në Evropë, kur i dëgjojnë ose i lexojnë reagimet e Presidentit të çekullibruar të SHBA-ve si për NATO-n, ashtu edhe për BE-në, e ashtu edhe për Brexit-in, kur e këshillon kryeministren britanike që ta çojë në gjyq Bashkimin Evropian.

Në gjithë këtë kaos, kur Departamenti i Shtetit nuk është askund për t'u parë, çdo herë e më tepër do të shohim deklaratatë të mjegullta të ambasadorit amerikan, i cili mund të jetë në pritje të ndonjë interviste, a ndonjë postimi befasues të shefit të tij.

Sigurisht që Greg Delawie nuk ka ndërruar qëndrim sa i përket ndarjes së Kosovës, a sa i përket këmbimit të territoreve, a kushedi

se për çfarë problemi tjetër. Delawie është thjesht në terr informativ. Ai për asgjë nuk mund të flasë me siguri të plotë, sepse mund të demantohet me ndonjë rikohetë nga Presidenti i SHBA-ve, duke postuar diçka pas mesit të natës në "Twitter".

Për momentin, politika e jashtme amerikane nuk po udhëhiqet nga Departamenti i Shtetit. Ky është një "one man show". Për habitinë e të gjithëve, Trump në samitin e Helsinikit u takua me Presidentin Putin kokë më kokë. U mbajtën jashtë zyrës edhe sekretari i shtetit Pompeo, e edhe këshilltari për siguri kombëtare Bolton. Edhe Putin, edhe Trump thanë që kanë arritur marrëveshje gjatë takimit mbi dy orësh. Se çfarë marrëveshjeje kanë arritur, këtë e dinë vetëm ata të dytë dhe dy përkthyesit që ishin brenda në sallë. Këtë nuk e di as Greg Delawie. Intervista e tij në Rubikon nuk ishte qëndrim i ri amerikan, ishte më shumë një mosqëndrim amerikan. Ishë reflektim i kaosit amerikan.

"Express"

Opinion *i* Ditës

Si duhet ta lexojmë mbështetjen ndërkombëtare për ministrin Xhafaj?

Nga Vincent Triest

(vijon nga faqja 1)

...më shumë mbështetje se të tjerët. Kjo vlen në veçanti për pozitën e ministrit të Brendshëm, i cili ndoshta kryen funksionin më të rëndësishëm të qeverisë shqiptare. Ai është përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike, arsye për të cilën ky pozicion mbetet më i kritikuar në historinë e pluralizmit shqiptar. Megjithatë, duket se kohët e fundit përfaqësuesit e komunitetit ndërkombëtar të pranishëm në Shqipëri nuk i kanë kursyer ministrin aktual të Brendshëm, Fatmir Xhafaj, një mbështetje të pazakontë. Dhe kjo po ndodh për një arsye domethënëse:

Pa u hyrë shumë stërholimeve, kjo arsye nuk lidhet drejtpërdrejt me largimin e pararendësit të tij, Saimir Tahirit, si ministër. Zëvendësimi i këtij të fundit, i cili është akuzuar për disa çështje tashmë të njohura për çdo shqiptar, ka qenë në fakt një lehtësim për të huajt. Por pas ikjes së tij, kishte nevojë për ndryshime thelbësore.

Nga disa burime prej qarqeve diplomatike të Tiranës kuptohet se ndërkombëtarët janë të kënaqur me ministrin e ri, duke e përshkruar Xhafajin si një zyrtar me eksperiencë, të aftë, që jo vetëm po pastrojnë rrënojat e lëna pas nga Tahiri, por edhe si njeri që po bën hapa pozitive në luftën kundër krimit të organizuar. Kjo e fundit është një nga prioritetet kryesore të caktuar nga Brukseli. Diplomatat theksojnë se në çdo rast, përmirësimi është i ndjeshëm, çka bie ndesh me atë që thoshin për paraardhësit e Xhafajit.

Ky fakt duket fare qartë nga mbështetja publike që shprehu ambasadori i SHBA, Donald Lu, për ministrin aktual të Brendshëm muajin e kaluar. Ai theksoi mbështetjen e fortë të SHBA-ve si dhe vendete të tjera partnere, për Ministrinë e Brendshme dhe Xhafajin personalisht në të gjitha përpjekjet e tyre për t'u dhënë qytetarëve më shumë rend e siguri. Ambasadori e inkurajoi Xhafajin dhe Policinë e Shtetit që të vijonin edhe më me intensitet përpjekjet për më shumë rezultate në luftën kundër krimit të organizuar, pasi sipas tij, një sipërmarrje e tillë është ajo çka qytetarët presin sot më shumë se çdo herë tjetër nga Policia e Shtetit. Fakti që Lu vazhdoi rrugën duke marrë Xhafajin në makinën e tij personale, lë pak hapësirë për imagjinatën.

Tek ambasadorët perëndimorë dhe rrethet diplomatike mbizotëron ideja se Xhafaj synon të trajtojë rrenjësitë problematikat e lidhura me rendin dhe sigurinë. Pastaj, që disa kolegë partiakë nuk e pëlqejnë atë, për rrethin diplomatik të pranishëm në Shqipëri përbën një shembull pune të mirë në sytë e tyre.



Megjithatë, prishmëritë janë të mëdha prej luftës së vështirë që ka ndërmarrë Fatmir Xhafaj. Problematikat e trashëguara s'janë aspak të thjeshta për t'u trajtuar. Policia në Shqipëri ka nevojë për një reformë të thellë që të luftojë me efikasitet krimin e organizuar, në mënyrë që vendi të çojë më tej procesin e nisur të integritit në BE. Është pikërisht kjo luftë ndaj shfaqjeve të ndryshme të kriminalitetit që do e afrojë vendin me Bashkimin Evropian.

Që ministri Xhafaj ka armiq është e qartë. Së pari, kjo është një "hakmarrje" e të gjithë kundërshtarëve të reformës së thellë në sistemin e drejtësisë, e cila më së shumti mban për autor pikërisht Fatmir Xhafajin në cilësinë e kryetarit të Komisionit të Posaqëm parlamentar për reformën. Por reforma sigurisht nuk i ka kënaqur

të gjithë dhe në kriterë janë bashkuar në një interes të vetëm dhe kundërshtarët politikë edhe të korruptuarit e sistemit. Që armiq politikë, qëftë në Partinë Socialiste, qoftë në Partinë Demokratike nuk bindin me këtë fakt, pak rëndësi ka. Pasi mendimi i rrethit diplomatik janë të bindur.

Së dyti, qëllimi duket qartësisht politik: goditja ndaj Xhafajit, e sidomos e punës së tij, do të cenonte imazhin e krejt qeverisë shqiptare. Për më tepër, sulmi ndaj ministrit që ka tërhequr më shumë mbështetje ndërkombëtare vitet e fundit nuk do linte pa pasojë edhe vetë imazhin e vendit, që do të rezultonte përfundimisht i kompromentuar. Arsye për të cilën suksesi i Xhafajit në Ministrinë e Brendshme do të thotë shumë më tepër se thjesht ambicia e një politikani për të lënë një emër të mirë pas.

Por, për të përforcuar imazhin e

Shqipërisë, e vetmja rrugë nuk mund të jetë ndërkombëtare. Policia e Shtetit duhet të vazhdojë të tregojë më shumë rezultate konkrete në luftën kundër krimit të organizuar. Ministri i Brendshëm i Shqipërisë dhe Policia e Shtetit duhet të luftojnë për një sistem ku kriminelin nuk mund të jetë i kurrsesi më ai sundimtari i rrugëve me makina luksoze, sikurse krimi nuk duhet të jetë fitimor në sytë të publikut.

Për ta arritur këtë ka vetëm një rrugë, e cila dikton një bashkëpunim më të madh me mediat vendëse dhe ato të huaja. Gazetarët shqiptarë dhe të huaj duhet të kenë më shumë akses në operacionet të policisë, pasi atyre nuk mund t'u serviren më vetëm filmime të gatshme. Mbi të gjitha, duhet të zgjerohet ndjeshëm stafi i marrëdhënies me gazetaret, pasi më shumë investime në atë fushë do sillte edhe më shumë rezultate.

Po kështu, rritja e transparencës nga ministria është e mirëpritur. Ajo duhet të nisë së më shpejt të publikojë shifra periodike për rezultate dhe për shifra që i duhen publikut si dhe media-ve për të interpretuar gjithçka që ndodh në Shqipëri. Ka ardhur koha për ministrin Xhafaj dhe Policinë e Shtetit për ta luftuar krimin haptazi, në sy të publikut!

HOROSKOPI

DASHI

Emocionet e forta mund të dëmtojnë sistemin tuaj nervor dhe duhet t'i kontrolloni. Sot humbjet financiare duken të mundshme, nëse bazohen tek fjalët e të tjerëve. Do të vini re se të afërmit nuk do t'i kuptojnë nevojat tuaja. Mos e përfshini veten në diçka të papërshtatshme.

DEMI

Fillojeni ditën me një stërvitje të vogël. Është koha që të filloni të ndiheni mirë me veten dhe bëjeni këtë çdo ditë. Bashkohuni sot me njerëz me përvojë dhe mësoni nga ajo që ata kanë për të thënë. Dëgjoni këshillat e dhëna nga të tjerët, nëse dëshironi të përfitonit sot.

BINJAKET

Duhet ta lini të kaluarën pas, nëse dëshironi të dilni nga dëshpërimi. Shikoni tendencën tuaj për të jetuar çdo ditë në maksimum. Gjendja juaj e keqe do të ndryshojë nga partneri juaj i jetës me disa surpriza të veçanta shumë të këndshme.

GAFORJA

Fuqia e vullnetit tuaj mund të shpërblehet sot, ndërsa përballen me një situatë shumë të ndërlikuar. Ju nuk duhet të humbni kontrollin ndërsa merri një vendim shumë emocional. Spekujmë do të jenë të rrezikshme, prandaj të gjitha investimet duhet të bëhen me kujdes të madh.

LUANI

Besimi dhe energjia juaj do të jenë të larta sot. Problemet financiare rënojnë aftësinë tuaj për të menduar në mënyrë konstruktive. Ditë e mirë për të vizituar një avokat për të marrë disa këshilla ligjore. Dikush mund të gjejti i pasjellshëm me ju. Mendojeni të gjitha emocione në jetën tuaj martesore.

VIRGJERESHA

Një ditë e mrekullueshme për t'i bërë gjërat që të lëvizin në drejtimin e duhur. Shpenzimet ndërkohë do të rriten. Dikush me të cilin jetoni mund të jetë i zhgënjyer dhe i mërzitur me sjelljen tuaj të rastësishme dhe të paparashikueshme. Sot do të takoni një mik të kujdesshëm dhe mirëkuptues.

PESHORJA

Mos e humbni energjinë me mendime të panevojshme të pamundurura, në vend që ta përdorni atë në një drejtim të duhur. Ju mund ta gjeni veten në një situatë të re emocionuese, e cila gjithashtu do t'ju sjellë përfitime financiare. Disa bashkëpunëtorë nuk do të pëlqejnë mënyrën tuaj të trajtimit të disa çështjeve të rëndësishme.

AKREPI

Sjellja juaj jo me klas do të prishë disi humorin partnerit tuaj. Duhet të kuptoni se mungesa e respektit e dëmton rëndë një marrëdhënie. Mos e tepron gjithashtu me shpenzimet për luksin e shtëpisë. Mos zbuloni informacione personale dhe konfidenciale.

SHIGJETARI

Vështirësitë financiare duket se kapërcëhen më lehtë, pasi prindërit tuaj ju japin mbështetje. Planifikimi i ditëve tuaja mund të prishet për shkak të një pune urgjente të partnerit tuaj, por më në fund do të kuptoni se kjo ka ndodhur për diçka të mirë.

BRICJAPI

Humbjet financiare janë të mundshme nëse investoni pa kërkuar këshillat e duhura. Edhe situata e dashurisë duket pak e acuruar, gjë që do të shtojë presionin te ju. Nëse jeni në një lidhje, tregohuni më i butë me partnerin, sepse mund të lëndoheni.

UJORI

Jini të fshehtë sa u përket investimeve edhe për qëllimet tuaja të ardhshme. Miqtë do të jenë më mbështetës nga sa e prisnit. Në punë gjërat duket se janë në favor tuaj. Asgjë nuk është e pamundur për sa kohë që ka një vullnet për t'i kapërcyer pengesat.

PESHQIT

Buzëqeshja është antidoti për të gjitha problemet tuaja. Është koha e duhur për të hequr qafë zakone tuaja të këqija. Mos harroni se hekur rritet sa është i nxehtë. Një mik i mirë në punë mund të bëhet vërtet i bezdisshëm sot. Bëni ndryshime që mund të përmirësojnë gjendjen tuaj.

Dje në "Deutsche Welle"

Përse gëzohet Kancelarja Merkel në pushimet e verës?

Grandje në qeveri, kërcënime për dorëheqje të ministrit të Brendshëm, goditje nga presidenti Trump; por Angela Merkel tregon në konferencën e shtypit të verës se qetësinë e saj nuk e prish asgjë.

Duhet të ngjiste shkallët për në konferencën e shtypit një njeri i kërrusur me rrathtë të zinj poshtë syve, që mezi e gjen fuqinë të ecë? Jo, Angela Merkel Kancelarja gjermane vjen me një xhakete të kuqe të ndezur, me humor. Si çdo vit edhe kësaj here kryetarja e qeverisë gjermane ndodhet përballë gazetarëve që lejohen të shtrojnë pyetje nga më të ndryshmet. Por ky nuk është vit si çdo vit tjetër, këtë e di edhe Merkel.

E QETË DHE E CLRUAR PAS JAVËVE TË MUNDIMSHME

Gati përditë e godet, gënjen ose e fyen presidenti Trump kancelaren. Edhe në Europë, të cilën Merkeli do ta shohë të bashkuar, ka më shumë grindje se kurrë më parë. Madje edhe brenda vendit, grindja me CSU-së nga Bavaria për politikën e azilit gati solli dështimin e qeverisë gjermane. Gjatë përshëndetjes Merkel merr vesh se ajo qëndron ulur në këtë sallë për të 23-n herë në karrierën e saj politike. "Mirë që dikush paska numëruar", thotë ajo.

POLITIKA SOCIALE, DIGJITALIZIMI, AZILI

Konferenca vazhdon, me një hyrje të Merkelit për atë që është më e rëndësishme. Në politikën sociale duhet të vendosen piketat ku duhet, në politikën e pensioneve dhe kujdesin shëndetësor ndaj të moshuarve, por edhe tek digitalizimi. Së shpejti pritet edhe një strategji e qeverisë për in-



teligjencën artificiale. Tjetra, qeveria po punon në mënyrë serioze. Ka miratuar dy buxhete brenda katër muajve.

Por edhe politika e azilit nuk harrohet. "Në politikën për refugjatët njerëzit presin nga ne siguri

dhe kontrollim të situatës." Asnjë fjalë për ministrin e Brendshëm, Horst Seehofer, që Merkelin e kërcënoi me dorëheqje në grindjen për azilin. Asnjë fjalë për Donald Trumpin, Putinin apo autokratit turk, Erdogan. Por gazetaret vazh-

dojnë të pyesin...Trump e quan Europën "armik"... "Po këtë e regjistroj dhe përpiqem të argumentoj të kundërtën", përgjigjet Merkel. "Kjo ka sigurisht të bëjë edhe me fuqinë tonë ekonomike". Por Trump nuk i përmbahet asnjë

ujdie, këmbëngulin gazetaret. Merkel e kundërshton këtë, dhe thotë këtë fjalë kuptimplote. "Kudri i rendit, me të cilin ne ishim mësuar për një kohë të gjatë po tronditet thellësisht."

MERKEL NUK E KA MENDUAR DORËHEQJEN

Po grindja brenda Gjermanisë? Konflikti i hapur mes partisë CDU dhe simotërës, CSU, nëse Gjermania duhet të kthejë në kufi refugjatët që janë regjistruar në vende të tjera, ashtu si dëshirojnë kristian-socialët? Merkel e kundërshton këtë. Pyetjet e gazetarëve drejtoheshin rreth grindjes që gati çoi në dështimin e qeverisë pak javë pas krijimit të saj. "Besoj se ne kemi nxitur pakënaqësinë politike." E më tej: "Toni ishte mjaft i ashpër. Unë personalisht nuk e pranoj erozionin e gjuhës, sepse kjo është shprehje e të menduarit." Në fund megjithatë kemi gjetur një ujdi, e kjo vlen të merret në konsideratë, sipas Merkelit. A kemi menduar ndonjëherë të jepnit dorëheqjen? "Jo!" thotë Merkel.

RUSIA BËN LUFTË HIBRIDE

Duhet të dëgjosh me kujdes për të mos e humbur momentin, kur Kancelarja shprehet me tone të qarta. Si e sheh ajo takimin mes Trumpit dhe Putinin në Helsinki, dhe çështjen, nëse Rusia e ka manipuluar fushatën zgjedhore amerikane? "Zhvillimi i luftës hibride është për Rusinë një mënyrë veprimi." Ky nuk është supozim, por përcaktim. Kështu mendon Merkel saktësisht për Putinin. E nëse kreu i Komisionit Europian, Jean-Claude Juncker në javën e ardhshme nuk arrin sukses në grindjen tregtare në takimet Trump, atëherë sipas Merkelit, Bashkimi Europian duhet të merret me "kundërmasat". Por ky do të ishte varianti më i keq.

PËRSE GËZOHET KANCELARJA GJERMANE?

Gazetarët vazhdojnë të pyesin, se si ndjehet ajo personalisht, se sa e kanë lodhur javët e fundit. Prej vitesh ata përpiqen të zbulojnë diçka më shumë nga jeta shpirtërore e kësaj gruaje 64 vjeçare. A nuk e bren e gjithë grindja e këtyre javëve? "Nuk më bren asgjë, për të gjithë në dalin sfida" e më tej "gëzohem për pushimet, sepse mund të fle më gjatë." Edhe njëherë vazhdojnë gazetaret të pyesin. Po nuk e ka lënduar grindja me Seehoferin? Nuk e ka ndryshuar? Jo, në fund ka pasur kompromise. "Dhe kompromiset janë konstruktive, ku në fund avantazhet tejkalojnë disavantazhet", thekson Merkel. E sikur të mos mjaftojë kjo, Merkel vë në dukje se do të qëndrojë në post gjatë gjithë mandatit të saj. "Sepse në tërësi bëhet fjalë për një kohë interesante dhe intrigues

DISA TË PLAGOSUR PAS NJË SULMI NË NJË AUTOBUS LINJE NË LYBEK

Disa të plagosur pas një sulmi në një autobus linje në Lybek. Nëntë të plagosur pas një atentati të një 34-vjeçari në Lybek. Dorasi ndërkohe u arrestua dhe prokuroria e Lybekut nuk e përjashton një sfond terrorist të kësaj vepre.


Sipas ministrit të Brendshëm të landit Schleswig-Holstein, Hans-Joachim Grote, gjatë sulmit ndaj pasagjerëve të një autobusi në Lybek u plagosën nëntë vetë. Gjashtë vetë u plagosën nga plagë të shkaktuara me thikë, tre në mënyrë të tjera. Dorasi e qëlloi shoferin e autobusit me grusht, tha Grote.

Sipas një raporti të dëshmitarëve okularë autobusi i mbushur plot po shkonte në drejtim të Travemündes kur një burrë nxori një thikë dhe sulmoi udhëtarët e tjerë. Shoferi e ndali menjëherë autobusin dhe hapi dyert në mënyrë që udhëtarët të mund të shpëtonin.



FOTOLAJM

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- Mund të jetë e pasur me minerale.
- Ascoli në tabela.
- Një mund të jetë diplomatik.
- Premtojnë të bëhen kampionë të tillë.
- Janë felinë të egër.
- Marubi i fotografisë.
- Janë meduza.
- Një anarkist i famshëm.
- Smith filozof.
- Susanna shkrimtare italiane.
- Shkurt për company.
- Organizma Autonome Kombëtare.
- Mbarojnë punime.
- Ndezur në aparatë.
- Bëjnë nda me re.
- Nduket për gjysmë.
- Mbyllin fushatë.
- Luca bomber.
- Emri i parë i Pasolini-t.
- Një mund të jetë fetar.

- Lidhen të parat.
- Fundi i një faze.
- Emri i Bismarck.
- Kant e Diabolik.
- Ze... në traget.
- Ente Informacioni Rajonale.
- Triplet e Trëndafilë me kredi.
- Rruga e Ferenc Molnar.
- Në krye të notarëve.
- Gjysmë tatimi.
- Ushtrihet me cd false.

VERTIKAL

- Numër i shkurtër.
- Britame Arkimedit.
- Inicialet e Paganini-t.
- Fundi i Turandot.
- Eshhtë fjetore ushtarësh
- Parker regjisor.
- Kështu quhet që ushqim kundër intoksimit.
- Një birrë e jona.
- Mund të jenë përirimi.
- Festat pa fat
- Qendër ditore
- Janë nomadë.
- Fillojnë atletikën.
- Eshhtë brinjë në skuadër.
- Sidney i Serpico.
- Qe centauri që mësonte Akilin.
- Në mes të një kanali.
- Bëhet për zakon.
- Tregon martesë.
- Një super... për shopping.
- Vala e stadiumit.
- Fillojnë poshtë.
- Një provë... intelligence.
- Vaçe e famshme e këngës tonë.
- Fillojnë vallen.
- Para es Salaam.
- Linearë pa larë.
- Nota e diapazonit.
- Mbyllin një shtëpi.
- I keni në dorë.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- Eshhtë skuadra e donatorëve
- Mbyllin një turp.
- Mund të jetë unik
- Një i absurdit është i Samuel Beckett
- Qyteti i përjetshëm.
- Interpreton Sandokan.
- I ka tek tenda.
- Eshhtë këngëtar lirik
- Arturo i Brecht.
- John, i forti i Sylvetster Stallone-s.
- Françesku kantautor.
- Eshhtë religjion politeist.
- Qerre pa qe.
- Gjysmë alarmi.
- Eshhtë shtypi i ZP.

VERTIKAL


- Janë çnjerëzore.
- Mund të jetë e hollë dhe therëse.
- Edi në krye të PS.
- Eshhtë lloj papagalli.
- Fund turni.
- Eshhtë dëshmore... çudibërëse.
- Para devils për lojtarë e Manchester United.
- U shkrua nga Kadare
- Conan ai i Schwarzenegger.
- Pak titanike.
- Arbeni pa çifte.
- I ka tek treni.
- Mund të jenë pushimi
- Mund të prishej nga jë... kleçkë.
- Në krye të bashkisë.
- Eshhtë kundërshtar në dashuri
- Meta në krye të LSI.
- I vidhet ustait.
- Jeppet e Artë në Cannes.
- Eshhtë pije e jona.
- Kufizojnë kënde.
- Fillojnë lehtë.
- Eshhtë dritëshkurtri.
- Eshhtë numri i... të parit.
- Fillojnë nazet.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

4				8				
	3	8		9				2
	7			1			4	
			3			9	5	
7								6
	5	2		4				
	6		7				1	
1			6		4	9		
			1					3

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

5	4	6	2	9	7	3	1	8
1	7	2	8	5	3	4	9	6
3	8	9	4	6	1	2	5	7
6	9	3	7	1	8	5	2	4
4	1	8	5	3	2	7	6	9
2	5	7	6	4	9	1	8	3
7	2	4	9	8	5	6	3	1
8	3	5	1	7	6	9	4	2
9	6	1	3	2	4	8	7	5

Argëtim filozofik

- Gabimi më i madh në jetë është të lejosh disa njerëz të qëndrojnë në jetën tuaj më shumë se sa e meritojnë!!!
- Të dashurosh dikë që nuk të do, është sikur të presësh një anije në aeroport.
- "Djemtë mendojnë se vajzat janë si libra. Nëse kopertina nuk tërheq vëmendjen e tyre, ata nuk shqetësohen për të lexuar atë që ekziston brenda". -Marylin Monroe
- E kaluara është mësues i së tashmes dhe udhëzues i së ardhmes.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

3	1	8	4	2	4	13	1	13				
18	3	1	4	18	5	17	13	1				
8	1	10	10	10	1	3	1	6	8			
6	1	10	2	3	6	14	1	12	2	4		
13	3	5	4	2	8	4	1	12	4	2		
15	9	6	15	1	12	4	6	6	3	18		
17	2	4	5	12	2	14	17	5	3			
8	1	7	6	3	1	10	1					
4	5	12		4	6	4	18	7	7	6		
1	A	1	R	2	E	8	S	1	5		2	3
13	19		1	3	20	5	4	6	10	6		
1	1	10	2	3	2	12	15	18	2	8		

- I lumtur është ai njeri që di se çfarë të mbajë mend nga e kaluara, çfarë të shijojë në të tashmen, dhe çfarë të planifikojë për të ardhmen.
- Pengesa më e madhe është frika ... ndjenja më e keqe është zemërimi... dhe gabimi më i madh është braktisja !!!

Thënie të mençura

- Rruga drejt lumturisë nuk është e drejtë ... Ka shumë kthesa të quajtura "gabime".
- Burgu më i madh në të cilin njerëzit jetojnë është frika se çfarë mendojnë të tjerët !!!

FJALËKRYQI (1)

R R E S F D E T I
M A M A M M E P K E L
A M I S I M O N I A B O
T O T R E T O R I K A
E N O K D O M A T E L
R M A R T I R E T T O
I A R A T O N E R R R
A N M O I L A R R O D
L N A D M A L T A
E N T E V E A P L R
T E R R I T O R I A L E M
K L A S A S P A R T A R U
K A R R I E R A A R T
M E R C E N A R O
G J A H U N I N J A
L J I T U G S U M O
L E E T O P A R
F I A T M S B R O T A
R M R S A O T E R O
O B E R O N M I A
N I N A M A T T H A U
T A S I T R O I D E T
I N T E R I M K E N

FJALËKRYQI (2)



